**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec**

---

**01 Nr. 04/19**
**Rahovec, 19.04.2019**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më **30 Prill 2019 ( Marte )** me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## R E N D  D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Raportit Financiar Janar – Mars 2019,
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i Plotësim ndryshimi të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale,
5. Shqyrtimi dhe aprvovimi i Vendimit të Kryetarit për miratimin e marrëveshjes për bashkëfinancim dhe themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndarje të shtëpive për banim,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit të Kryetarit për themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike "Sulejman Krasniqi",
7. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit të Kryetarit për caktimin e datës 7 dhjetor si Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" në Rahovec,
8. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Planit të Veprimit për Transparencë Komunale 2019 - 2023
9. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për Themelimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, shpalljen e konkursit dhe caktimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve në komitet,
10. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës kullosë e klasës së 6 në tokë ndërtimore për Zonën Ekonomike në fshatin Opterushë,
11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për dhënien e pëlqimit për shfrytëzimin e ngastrave kadastrale 777, 778 dhe 779 në vendin e quajtur Rakita – Xërxë, kompanisë "NTP Vëllezërit Morina"
12. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Rregullores për Mënyrën dhe Kushtet e Shfrytëzimit të Palestrës së Sporteve "Mizahir Isma" Rahovec,
13. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 591 të datës 16.02.2018, për Themelimin e Komitetit për Komunitete,
14. Shqyrtimi dhe aprovimi i Vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për festivalin tradicional mbarëkombëtare të folklorit "Anadrinia Jehon 2019"

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Afrim Dina**

Nr. Protokollit:
Rahovec: 30.04.2019

**D R A F T**

**RREGULLORE NR. 02/2019**

**PËR**

**MËNYRËN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SË SPORTEVE "MIZAHIR ISMA" NË RAHOVEC**

**Rahovec, Mars 2019**

Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja i) dhe nenit 58 shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L–040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008, nenit 12 paragrafi 2 pika 2.1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.03.2019 propozon këtë:

# DRAFT - RREGULLORE PER MËNYREN DHE KUSHTET E SHFRYTËZIMIT TË PALESTRËS SË SPORTEVE "MIZAHIR ISMA" NË RAHOVEC

## Neni 1
## Qëllimi

Me këtë rregullore përcaktohen mënyrat dhe kushtet e shfrytëzimit të Palestrës Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec, për aktivitetet sportive të klubeve të regjistruara në Federatat gjegjëse, manifestimeve të ndryshme të kulturës, tubimeve partiake, rekreacionit dhe grupeve joformale.

## Neni 2
## Përkufizimet

1. **DKRS** – Drejtoria për Kultur, Rini dhe Sport.
2. **Objekt Sportiv** – nënkupton objektin ku ndodhet zhveshtorja, lokalet, hapësirat teknike dhe logjistike, fusha sportive me të gjitha pajisjet tjera mbështetëse.
3. **Menaxher** - personi zyrtar që kujdeset për planifikim dhe organizim të punëve, koordinim me klubet, komunikim me strukturat e Komunës, kontrollin e stafit, raportimin e punës, etj.
4. **Aktivitetet Shkollore** - aktivitetet të cilat organizohen nga shkollat e rregullta të Komunës së Rahovecit nën përkujdesjen e një mesuesi apo grup mësuesish të rregullt të shkollës (shkollave) përkatëse.
5. **Shkollat e Sportit** - nënkuptojnë organizatat (klubet) sportive ( basketboll, futsal, hendboll, volejboll, etj) të cilat janë themeluar me të vetmin qëllim të edukimit në sport dhe për zhvillimin e aktiviteteve sportive.
6. **Klub Sportiv** - organizatat sportive të profilizauara në basketboll, futsal, hendboll, volejboll, etj të regjistruara si OJQ apo Shoqëri Aksionare, publike apo private, të cilat garojnë në ligat përkatëse të Republikës së Kosovës dhe janë nën ombrellën e Federatave përkatëse të Republikës së Kosovës.

## Neni 3
## Funksioni i Palestrës Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec

1. Funksioni primar i Palestrës Sportive "Mizahir Isma" në Rahovec është që të krijoj kushte për zhvillimin e aktiviteteve sportive, rekreative, kulturore, artistike, koncertet, tubime dhe ngjarje të tjera të organizuara .
2. Në palestër mund të zhvillohen ndeshje dhe stërvitje të sporteve të cilat janë të përshtatshme vetëm për ambiente të mbyllura si: Basketboll, Hendboll, Volejboll, Futsal dhe sporte të tjera të licencuara.
3. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete tjera sportive të cilat vlerësohen si jo të rezikshme për dëmtimin e dyshemesë dhe të ambienteve tjera.

4. Në palestër mund të zhvillohen aktivitete promovuese kulturore ,sportive, ekonomike, tubimet nga fusha politike etj.

**Neni 4**

**Struktura organizative e objektit sportiv**

1. Struktura organizative e objektit sportiv përcaktohet me organogramin e Komunës, respektivisht DKRS-së.
2. Struktura organizative për menaxhimin e objektit sportiv përbëhet nga: zyra administrative e palestrës, kujdestaria e objektit sportiv, punëtorët teknik, mirëmbajtës të pastërtisë dhe punëtorët e sigurisë.
3. Klubet sportive, respektivisht përfaqësuesit e klubeve që kanë bërë marrëveshje me menaxhmentin e palestrës së sporteve janë partner dhe konsiderohen persona përgjegjës për kohën kur zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive.

**Neni 5**

**Mirëmbajtja dhe Investimet Kapitale**

1. Të hyrat që gjenerohen nga aktivitetet në palestër do të derdhën në llogarinë bankare të Komunës së Rahovecit.
2. Menaxhmenti i objektit obligohet të njoftoj DKRS-në për çdo prishje, demolim dhe për çdo intervenim tjetër me anë të kërkesës.
3. DKRS e shqyrton kërkesën e parashtruar për intervenim në mirëmbajtje, e rekomandon te Kryetari i Komunës për aprovim.
4. Investimet kapitale të nevojshme në objektin sportiv realizohen nga buxheti i Komunës së Rahovecit.
5. Nevojat për investimet përcaktohen nga DKRS-ja dhe aprovohen nga Kryetari i Komunës.

**Neni 6**

**E drejta për shfrytëzimin e palestrës sportive**

Të drejtë shfrytëzimi në palestrën sportive kanë: Institucionet shtetërore, klubet sportive, organizatat politike, organizatat joqeveritare, bizneset, institucionet shkollore, Universitetet, Institucionet ndërkombëtare si dhe grupe tjera formale dhe joformale.

**Neni 7**

**Mënyra e shfrytëzimit të palestrës sportive**

Mënyra e shfrytëzimit të palestrës sportive rregullohet me anë të marrëveshjes së arritur të palës së interesuar me menaxherin e objektit të palestrës sportive, e cila nënshkruhet nga menaxheri i palestrës dhe palës së interesuar.

**Neni 8**

**Kërkesa për shfrytëzim**

1. Pala e interesuar për shfrytëzim të palestrës duhet të paraqes kërkesë së paku 3 (tre) ditë para mbajtjes së aktivitetit.
2. Kërkesa i drejtohet me shkrim Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, i cili obligohet për të kthyer përgjigje me shkrim brenda **24 orëve. (48 orëve) - ??**
3. Klubet sportive të Komunës së Rahovecit të cilat janë të licencuara në Federatat përkatëse dhe që kanë kalendarin e rregullt të garimeve nuk i nënshtrohen paragrafit 2 të këtij neni.
4. Udhëheqësit e klubeve sipas paragrafit 3 të këtij neni obligohen që për çdo fillim të vitit në muajin Janar ti prezantojnë përgjegjësit të palestrës orarin e aktiviteteve të veta.

**Neni 9**
**Orari i shfrytëzimit të hapësirës së palestrës**

1. Objekti sportiv është në funksion 7 ditë në javë duke filluar nga ora 8:00h deri 24:00h.
2. Orari i rregullt i punës është nga dita e Hënë deri të Premten nga ora 8:00h deri 24:00h.
3. Oraret tjera që nuk përkojnë me pikën 2 të këtij neni duhet të rezervohen me kërkesa të posaçme siç është cekur në nenin 8 të kësaj Rregulloreje.
4. Për lokalet që janë në kuadër të palestrës sportive "Mizahir Isma" do të zhvillohet procedurë për dhënie në shfrytëzim sipas Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës .

**Neni 10**
**Rregullat themelore për shfrytëzimin e Palestrës sportive" Mizahir Isma" në Rahovec**

1. Për pakënaqësit eventuale, shfrytëzuesi duhet të drejtohet me ankes në DKRS.
2. Menaxheri i palestës ka të drejtë të suspendoj përkohësisht shfrytëzuesin e sallës për mosrespektimin e kritereve të përcaktuara në marrëveshje dhe rregullave sipas dispozitave të kësaj rregulloreje deri në vendimin tjetër të DKRS-së.
3. Shfrytëzuesi i palestrës duhet të identifikohet dhe të regjistrohet çdo herë para shfrytëzimit të palestrës dhe të respektojë orarin e caktuar në marrëveshje me personat përgjegjës në palestër.
4. Ndalohet pirja e duhanit në të gjitha hapësirat brenda palestrës.
5. Pas shfrytëzimit të hapësirave në palestër dhe zhveshtoreve, kujdestarët kontrollojnë hapësirat për të verifikuar gjendjen.
6. Klubet dhe individët duhet të kujdesen vetë për gjërat e tyre personale, menaxhmenti i palestrës nuk e merr përgjegjësinë për gjërat e humbura në palestër.
7. Shfrytëzimi i palestrës bëhet me pages sipas tarifës së caktuar me këtë rregullore, përjashtim bëjnë vetëm subjektet e liruar.
8. Pajisjet që përdoren në palestër nga sportistët duhet të jenë të përshtatshme me ambientin e palestrës, përjashtohen rastet kur ka ndonjë marrëveshje të posaçme me DKRS-në.
9. Ndalohet hyrja në parket me këpucë të papastra që lënë gjurmë.
10. **Ndalohet shitja e rekuizitave, pijeve, ushqimeve dhe gjërave tjera në objektin sportiv.**
11. Fëmijët nën moshën 16 vjeçare duhet të jenë nën përcjelljen e prindit apo kujdestarit të tyre.
12. Ndalohet hyrja me kafshë në palestër, në përjashtim të rasteve kur kafsha i ndihmon personit me aftësi të kufizuara.
13. Ndalohet në zhveshtore çdo lloj i pijeve alkoolike apo pijeve me ambalazh qelqi ndërsa lejohen pijet freskuese të lojës.
14. Ndalohet hyrja në palestër me biçikleta, skateboard apo çfarëdo mjeti tjetër transportues, me përjashtim të personave me aftësi të kufizuara.
15. Ndalohet hyrja me armë, përjashtim bëhet vetëm për personat e autorizuar të sigurisë në detyrë.
16. Ndalohet vendosja e posterëve dhe njoftimeve tjera pa leje me shkrim nga ana e menaxherit të palestrës.

## Neni 11
## E drejta e sponsorizimit ( reklamave )

1. Reklamimi i sponsorëve bëhet me marrëveshje të posaçme me Komunën, respektivisht me DKRS-në.
2. Reklamimi i sponsorëve bëhet në këto vende: dysheme, në anësore të fushës, në rrethoja, në mure të objektit, në hapësira të jashtme etj.
3. Në dysheme mund ti vendosin reklamat e veta vetëm sponsorët që kontribuojnë me vlerë prej 5.**000.00 € ( Pesë mijë euro) në vit.**
4. Palët që vendosin reklamat janë përgjegjës për dëmet eventuale që shkaktohen gjatë vendosjes dhe heqjes së reklamave dhe obligohen që ti marrin përsipër të gjitha shpenzimet për riparimet e nevojshme.
5. Të drejtë për vendosjen e reklamave në objektin sportiv kanë të gjitha firmat/organizatat që arrijnë marrëveshje me klubet sportive dhe Komunën - DKRS.
6. Çmimet e reklamimit ndryshojnë prej madhësisë, vendit dhe pozitës së reklamës.

7. Subjekteve të interesuara u mundësohet vendosja e reklamave me këto dimesione dhe tarifat mujore dhe vjetore:

**7.1.** Në qendrën e fushës së basketbollit - futsal në parket ---------300 Euro/ mujore ;3000 Euro / vjetore.

**7.2.** Në gjysmërrethin e reketit të fushës së basketbollit-futsalit --- 250 Euro/mujore; 2500 Euro /vjetore.

**7.3.** Në hapësirësn e 7-metërshit të fushës së futsallit 2 x 0.60m -- 200 Euro/ mujore ;2000 Euro /vjetor.

**7.4.** Në hapësirën brenda fushës së basketbollit dhe hendbollit 2x0.60m - 200Euro/mujore;2000Euro/vjet.

**7.5.** Rreth vijave të fushës së basketbollit dhe hendbollit 3 x 0.60m -100 Euro/ mujore;1000Euro vjetor.

**7.6.**Në pjesën anësore (veriore dhe jugore në muri) të palestrës 3 x 0.60m -100Euro/mujore;1000 vjetor.

7.7. Në pjesët tjera të palestrës dimensioni 2 x 0.60m --50 Euro/mujore – 500 Euro / vjetore.

7.8.Transmetimi i ngjarjeve në Palestër nga Kompanitë televizive në rast se nuk janë ftuar nga subjekti
që organizon aktivitetin, paguajnë tarifë fikse ...................... 100 Euro.

**8.**Kohëzgjatja e vendosjes së reklamave në vendet e zgjedhura do të jet deri në një vit, me të drejtë vazhdimi sipas kontratës së re.

9. Vendi i vendosjes së reklamës caktohet me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes.
10. Shpenzimet e shkrimit, vendosjes dhe zhvendosjes së reklamës i bartë subjekti i cili ka vendosur reklamën.
11. Pagesa për reklamën e ekspozuar bëhet çdo muaj/vit dhe atë nga data 1-5 të muajit vijues.
12. Në palestrën sportive, klubet mund të ekspozojnë reklamat lëvizëse të sponzorëve të tyre vetëm gjatë orarit të ndeshjeve të tyre por me kusht që mos të pengohen reklamat ekzistuese në palestër.
13. Në rastet kur paraqiten dy ose më shumë kërkesa për reklam në të njëjtin vend, përzgjedhja bëhet me licitacion ( ofertës dhe kërkesës më të favorshëm ).

## Neni 12
## Dokumentacioni i nevojshëm për shfrytëzimin e palestrës

1. Klubet e interesuara për zhvillimin e aktiviteteve të tyre të rregullta sportive duhet të sjellin te menaxheri i palestrës këto dokumente:

**1.1.**Çertifikatën e regjistrimit;
**1.2.**Çertifikatën fiskale;
**1.3.**lejen e njoftimit të personit përgjegjës;
**1.4.**Rexhistrin e anëtarëve (lojtarëve) të klubit;

**2.** Klubet e regjistruara dhe menaxheri i palestrës pas shqyrtimit të kërkesës së klubit lidhin marrëveshje me shkrim për shfrytëzimin e palestrës.

**3.** Subjektet tjera që nuk janë klube sportive të regjistruara për shfrytëzimin e palestrës sportive duhet të paraqesin kërkesën për shfrytëzim.

**Neni 13**
**Pagesat për shfrytëzimin e objekteve në palestër**

**1.** Të gjitha klubet që janë të licencuara në Federatat përkatëse dhe figurojnë edhe në regjistrin e DKR-së, apo garojnë në kuadër të Federatave përkatëse e që janë nga Komuna e Rahovecit, mund ta shfrytëzojnë palestrësn për stërvitje dhe garim në bazë të një orari të rregullt, të rregulluar nga përgjegjësi i palestrës në bashkëveprim me udhëheqësit e këtyre klubeve dhe të vërtetuara nga DKRS sipas këtyre pagesave dhe kritereve:

**1.1.** Për stërvitje sportive -------------------------------- pa pagesë ( për një orë );
**1.2.** Për grupet formale ( të licencuara ) dhe joformale ( jo të licencuara )komunale:
- **a)** 15 Euro pa ndriçim ( 1 orë );
- **b)** 20 Euro me ndriçim ( 1orë );

**1.3.** Për stërvitje të grupeve private:
- **a)** 15 Euro pa ndriçim ( 1 orë );
- **b)** 20 Euro me ndriçim ( 1orë );

**1.4.** Për zhvillimin e ndeshjes pa bileta pagesa e shfrytëzimit të palestrës do të jetë - 30 Euro (1orë);
**1.5.** Për zhvillimin e ndeshjes me bileta, 30% e mjeteve të inkasuara nga shitja e biletave derdhen në llogarinë e Komunës, pjesa tjetër prej 70% derdhen në llogarinë e shfrytëzuesit të palestrës (klubit);
**1.6.** Të gjitha klubet sportive që nuk janë të Komunës së Rahovecit, të cilat për shkaqe të ndryshme janë të interesuara të shfrytëzojnë Palestrën Sportive në Rahovec, duhet të paguajnë 100 Euro për një orë.
1.7.Garat komunale, regjionale dhe Republikane të organizuara nga shkollat e Komunës së Rahovecit, **lirohen nga pagesa** e shfrytëzimit të palestrës sportive.

**2.** Palestra sportive mund të shfrytëzohet edhe për manifestime dhe ngjarje të ndryshme sipas çmimeve :

2.1.Për ngjarje komerciale ( panaire, revy, ekspozita , dhe të ngjashme) ------- 200 Euro/ 1 ditë
2.2. Për organizimin e tubimeve elektorale të subjekteve të ndryshme politike ---- 150Euro / 1 orë.
2.3.Për ngjarje humanitare -------------------------------------------------- pa pagesë
2.4.Për koncerte të ndryshme 30% nga inkasimi i mjeteve prej biletave të shitura do të derdhen në llogarinë e Komunës ose pagesa fikse e përcaktuar me marrëveshje.
2.5. Të hyrat që realizohen përmes fletëpagesave specifike të cilat hartohen nga Komuna e Rahovecit me logon e DKRS-së.
2.6. Të hyrat derdhen në arkën e Komunës së Rahovecit.
2.7. Pagesat realizohen vetëm përmes xhirollogarisë.
2.8.Nga obligimet financiare lirohen të gjitha organizimet Shtetërore që bëhen nga Komuna për nder të Festave Shtetërore - Kombëtare qofshin ato me karakter edukativ, kulturor ,sportiv etj
2.9.Nga obligimet financiare lirohen subjekt - Shoqatat të dalura nga Lufta, FSK, njësitë Policorë, KFOR-i, Personat me aftësi të veçanta pas aprovimit nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 14**
**Masat ndëshkuese**

1. Ndaj palëve të cilët nuk respektojnë rendin shtëpiak dhe nuk i binden menaxhmentit të objektit sportiv do të ndermirën masat ndëshkuese, suspendim i përkohshëm nga e drejta e shfrytëzimit të paslestrës sportive me kohëzgjatje të caktuar nga përgjegjësi i palestrës dhe nëse përsësritet më shumë se dy herë i njëjti veprim, atëherë i ndalohet e drejta e shfrytëzimit të palestrës deri sa organizata ose klubi të ndërmerr masat konkrete në vetëdijesimin ose largimin e të njëjtit akterë nga përbërja e tyre.
2. Për dëmet eventuale të shkaktuara nga klubet apo subjektet tjera përkatëse përgjegjësia bie te shfrytëzuesi i cili e ka shkaktuar dëmin, kompensimi duhet bërë në afat prej 5 (pesë) ditëve në xhirollogarinë e Komunës së Rahovecit.
3. Dëmet e shkaktuara vlerësohen nga komisioni ad-hoc prej 3 deri 5 anëtarëve të emëruar nga DKRS-ja i cili ka për obligim të përgatitë procesverbal të posaçëm për dëmet e regjistruara.
4. Në rast të mos kompensimit të dëmeve në afatin e paraparë sipas paragrafit 2 të këtij neni, inicohet procedura gjyqësore përmes përmbaruesit privat duke përfshirë edhe kamatën ligjore si dhe ndalesën për shfrytëzim deri në zgjidhjen e kontestit.

**Neni 15**
**Rregullimi dhe ndryshimi i mjedisit**

1. Ndryshimet në objektin e palestrës bëhen vetëm me lejen e Komunës, - DKRS-së.
2. Projektet për investime kapitale në palestër bëhen duke u bazuar në udhëzimet e akteve ligjore dhe nënligjore që e rregullojnë veprimtarinë përkatëse.

**II. DISPOZITAT KALIMTARE**

**Neni 16**
**Zbatimi i Rregullores**

Për zbatimin e kësaj rregulloreje përgjegjës është Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe subjektet të tjerë që e shfrytëzojnë hapësirat e palestrës sportive.

**Neni 17**
**Hyrja në fuqi**

1. Çdo dispozitë e kësaj Rregullore që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi përparësi do të kenë dispozitat ligjore në fuqi.
2. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin **mbikëqyrës** MAPL-në dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

**Afrim Dina**

**Kryesues i Kuvendit**

Në bazë të nenit 12 pika 1, nenit 17 shkronja (a) dhe nenit 40 pika 2 shkronja (a) dhe (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës Nr.03/L-040,(Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, 28/2008), nenit 12, nenit 39 , 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017,Propozimit të Kryetarit të Komunës me Nr.01/129/19 të dt.08.04.2019Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. ____________ miraton këtë

**Ndryshimin dhe Plotsimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017.**

1. Miraton **NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN e** Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017.

2. Në **nenin 8** të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017 të Plotsohet me, si vijon :

**Neni 8**

Taksat për dhënien me qira të hapësirës publike dhe aseteve nëntoksore për shfrytëzimin komercial paguhet :

| **Nr.** | **Emërtimi** | Egzistuese | Propozim |
|---|---|---|---|
| **8** | **Vendosja e objekteve MDF- Kutia (trafot , njësorë etj ) në sipërfaqet publike..** | **150.00 €/m2 vjetore** | **200.00€/m2 vjetore** |

3. Në **nenin 8.2** të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017, të Plotsohet edhe me një pikë si vijon:
   - Tarifat komunale do të aplikohen vetëm njëher në shumën e përcaktuar në tabelarin Nr. 8 në bazë të kushteve Urbanistike për ormatësit dhe trafot e KEDS-it.
4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, **NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI** i Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale do të jetë pjes përbërse e tekstit të Rregullores në fuqi.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky **NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI** i Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***U dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01-Nr.________**
**Datë: __________**

**Afrim Dina**

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. protokollit 01/1129/19
Me datë: 08.04.2019
Rahovec

Në bazë të nenit 11 dhe nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040,("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15, qershor 2008 ), Nenit 12 paragrafi 2.1 dhe Neni 74 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës :

**P R O P O Z O N**

**Ndryshimin dhe Plotsimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017.**

1. Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit **NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN e** Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017.

2. Në **nenin 8** të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017 të Plotsohet me, si vijon :

**Neni 8**

Taksat për dhënien me qira të hapësirës publike dhe aseteve nëntoksore për shfrytëzimin komercial paguhet :

| Nr. | Emërtimi | Egzistuese | Propozim |
|---|---|---|---|
| 8 | **Vendosja e objekteve MDF- Kutia (trafot , njësorë etj ) në sipërfaqet publike..** | **150.00 €/m2 vjetore** | **200.00€/m2 vjetore** |

3. Në **nenin 8.2** të Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale me 01Nr.576 të dt. 28.02.2017, të Plotsohet edhe me një pikë si vijon:
   - Tarifat komunale do të aplikohen vetëm njëher në shumën e përcaktuar në tabelarin Nr. 8 në bazë të kushteve Urbanistike për ormatësit dhe trafot e KEDS-it.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, **NDRYSHIMI DHE PLOTËSIMI** i Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale do të jetë pjes përbërse e tekstit të Rregullores në fuqi.

***U dërgohet :***

- ***Kryesuesit dhe Anëtarëve të Kuvendit***
- ***Sekretarisë së Kuvendit dhe***
- ***Arkivi***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

# PROCESVERBALI

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.03.2019** me fillim në ora **10.15.** Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatoj se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi,

**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes, i nderuar kryetar i komunës z. Smajl Latifi, nënkryetar i komunës z. Fatmir Iska , drejtor të drejtorive komunale, të nderuar kuvendar, pjesëtar të KFOR-it, OSBE-së, gazetar dhe media. Kuvendar të nderuar pasi që dje është funksionalizuar KQZ- ja janë marr vendime për plotësimin e vendeve të lira të asambleve komunale i kemi tre asamblist të cilët duhet të zëvendësohen kemi z. Fehmi Hoxha nga rrallët e PDK- së, znj. Shqipe Tara dhe znj. Rukije Krasniqi nga rrallët e AAK – së. Kërkoj nga tre asamblist të rijnë të ngritën në këmbë dhe të japin betimin unë do të lexoj dhe ju do të shqiptoni emrin e juaj. Unë Rukije Krasniqi, Fehmi Cena, Shqipe Tara betohemi se do ti kryej me nder, besnikëri pa anime dhe me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyra dhe autorizimet e mia do ti ushtroj.
Besoj se rendin e ditës dhe materialin e keni marrë me kohë? Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve,**
3. **Shqyrtimi i bartjes (rialokim) të të hyrave vetanake nga viti 2018 - 2019,**
4. **Shqyrtimi i Vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër,**
5. **Shqyrtimi i Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve,**
6. **Shqyrtimi dhe marrja e Vendimit për dalje në debat publik të Draft Rregullores rreth mënyrës dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve "MIZAHIR ISMA" në Rahovec,**
7. **Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale të Komunës së Rahovecit,**
8. **Informatë nga Komiteti për Auditim të Brendshëm të Komunës së Rahovecit,**
9. **Informatë mbi Raportin final të auditimit të brendshëm të Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit për vitin 2018,**
10. **Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimërorë.**
11. **Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për Nismën e bashkëpunimin ndërkomunal.**

**Kryesuesi** – Kuvendar të nderuar për këtë mbledhje na ka ardhur edhe një pikë shtesë, Shqyrtimi dhe aprovimi i propozim vendimit për Nismën e bashkëpunimin ndërkomunal. Kjo pikë është pak me urgjencë, prandaj ju kërkoj që të jetë pjesë e rendit të ditës për mbledhje të sodit, për më shumë e ftoj Kryetarin e Komunës që të arsyetojë.

**Kryetari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka hapur thirrje para dy dite dhe një komponent ku mundemi të përfitojmë bashkëpunimin ndërkomunal, në kuadër të këtij bashkëpunimi mund të fitojmë një grand prej 150,000.00 deri në 300,000.00 € i cili grand duhet patjetër ti përfshijë dy komuna të caktuara të Republikës së Kosovës, në këtë rast ne jemi dakorduar me komunën e Gjakovës e cila dje në asamblenë komunale e ka kaluar nismën për fillimin e bashkëpunimit komunal për të aplikuar në realizimin e një projekti që është në interes të përgjithshëm publik, edhe më herët kemi pasur bashkëpunime ndërkomunale mirëpo tani janë procedurat të cilat duhet të kalojnë në kuvend dhe të aprovohet Nisma dhe vendimi që të shkojmë më tutje. Kjo kërkesë ka ardhur në takimin e fundit që e kanë pasur para 2-3 dite komunat e Kosovës përkatësisht edhe përfaqësues zyrtar të komunës sonë, ideja është që ne të votojmë Nismën e bashkëpunimit ndërkomunal me komunën e Gjakovës për ta realizuar projektin e rregullimit dhe trajtimit të pendës së dëmtuar bashkë me Gjakovën pasi që është në kufi dhe fondet janë të ministrisë së administrimit të pushtetit lokal, ne përmes aplikacionit të përgatitur bashkë me komunën e Gjakovës të realizojmë këtë projekt që është me rëndësi të veçantë në çdo aspekt për trajtimin e asaj pjese të Drinit të bardhë nën Urën e Fshejt. Në qoftëse ju jeni dakord në menjëherë mund të procedojmë së pari të fusim në rend dite pasi që është urgjente dhe afati i aplikimit është deri më 10 prill. MAPL-ja është ajo që ka kërkuar në projekte në bashkëpunim ndërkomunal ti kalojmë me komuna të cilat mund të kemi marrëveshje pasi që komuna e Gjakovës e ka kaluar besoj që edhe kuvendi jonë duhet të kaloj këtë pikë të rendit të ditës për shkak se ne mund të fitojmë këtë grand i cili është me interes të veçantë. Kërkoj ndjesë që materiali ka ardhur me vonesë dhe urgjenca nuk është varur nga ne.
**Kryesuesi** – Kuvendar të nderuar e qesim në votim pikën shtesë të rendit të ditës, konstatoj se unanimisht aprovohet pika shtesë e rendit të ditës. Të nderuar tani e qes në votim rendin e ditës për këtë mbledhje: Konstatoj se rendi i ditës së bashku me pikën shtesë janë aprovuar në mënyrë unanime. Kalojmë pikën e parë të rendit të ditës:
**1.Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
**Kryesuesi** – A ka dikush të jepe ndonjë vërejte apo ndonjë sugjerim sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për ju kryesues, kryetarin, nënkryetarin, anëtar të kuvendit komunal, drejtorët, pjesëtar të OSBE-së, LMT-ës, media, unë e di që sekretaria e kuvendit është e ngarkuar me punë, ndonjëherë bëhen disa lëshime dhe gabime drejtshkrimore në procesverbal, ndoshta pse nuk dëgjohen mirë incizimet, por janë bërë disa gabime teknike tek diskutimi im faqe 7 dhe 11 kërkoj që këto gabime teknike të përmirësohen.
**Dervish Qadraku** – Përshëndetje për të gjithë janë duke u bërë disa gabime drejtshkrimore, është mirë të korrigjohen këto p.sh e kam hasur një gabim tek vendimi i pikës shtesë ku e keni cekur urra e shejtë ju lutem duhet të shkruhet Urra e Fshejtë duhet të keni kujdese më shumë që të mos i humbet kuptimi.
**Trajko Shariq** – Përshëndetje për të gjithë, në procesverbal është cekur vetëm Hoqë e madhe kur është përmendur çështja e projekteve me prioritet, në ndërkohë është përmendur edhe Rahoveci por nuk është përfshirë në procesverbal.
**Kryesuesi** – Kuvendar të nderuar të gjitha këto gabime sekretaria e kuvendit pas përfundimit të mbledhjes do i përmirësoj. E qes në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e 2 të rendit të ditës.
**2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e këshilltarëve.**
**Kryesuesi** - A ka ndonjëri nga drejtorët që ti përgjigjet kuvendarëve në pyetjet e parashtruara nga mbledhja e kaluar, nëse nuk ka atëherë e hapim debatin, fjala është e juaja të nderuar kuvendar nëse keni të parashtroni ndonjë pyetje për ekzekutivin.
**Rexhep Oruçi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, pyetja ime i drejtohet Drejtorisë për Shëndetësi, pyetje ime ka të bëjë rreth diskriminimit të një kategorie të pensionistëve, kur kemi të bëjmë me shërbime shëndetësore për pensionistë. Ligji për pensionistë i republikës së Kosovës i përfshinë shumë kategori të pensionistëve, shumica i e kategorive të pensionistëve të Kosovës i shfrytëzojnë shërbimet

shëndetësore falas, por një kategori e pensionistëve invalidor kur të shkojnë për ti shfrytëzuar shërbimet shëndetësore në QKMF, administrata e QKMF-së ja shikojnë moshën se a janë në pension për të mos paguar shërbimet, por ka pensionistë invalidorë që janë të moshës deri në 45 vjeç, dhe nga kjo kategori i kërkohet që të paguajnë shërbimet shëndetësore edhe pse janë pensionistë, mendoj se kjo është në kundërshtim me ligjin. Kërkoj nga Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë që të i njoftojë QKMF-në dhe AMF-të, dhe mos të i eliminojnë këtë kategori të pensionistëve nga ajo që i mundëson ligji.
**Mirjeta Krasniqi** - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, çështja të cilën unë do e ngrisë ka të bëjë me DKA-në, por së pari përgëzoj për suksesin e arritur në olimpiadën e fizikës nga nxënësi Selim Krasniqi dhe arsimtari z. Afrim Krasniqi, të cilët vinë nga shkolla Milaim Krasniqi – Postaseli, të cilët e kanë zënë vendin e dytë në nivel republike. Pas këtij suksesi shoqata e fizikantëve ka kërkuar pjesëmarrjen e nxënësit në gara të fizikës të cilat do të mbahen në Rika të Letonisë, ku ata e kanë dorëzuar kërkesën në DKA për mbulimin e shpenzimeve, kërkesa e njëjtë është bërë edhe nga prindi i nxënësit. Nga informatat që i kemi nga familjarët e nxënësit, komuna do e mbështesë nxënësin vetëm me 50% të shumës së shpenzimeve që do i bëjë[ nxënësi në Rika të Letonisë, pra nga 1000 € që ka qenë kërkesa, komuna vetëm 500 € do e mbështesë. Shuma prej 500 € nuk mjafton që nxënësi të i mbulojë të gjitha shpenzimet, dhe kjo ka rezultuar që të tërhiqet nxënësi nga kjo garë, mënoj se kjo garë i bënë mirë gjithë komunës, qysh në fillim është përkrahur nga DKA-ja, prandaj ne kërkojmë që të gjendet një mënyrë dhe nëse është e nevojshme edhe ne si kuvend të marrim një vendim për ndarjen e shumës prej 1000 €, sot është dita e fundit që të bëhet konfirmimi në shoqatën e fizikantëve për pjesëmarrje apo mospjesëmarrje. Për ne është nder dhe privilegj që nxënësi nga komuna jonë të shkojë në gara ndërkombëtare, uroj që të kemi raste te tilla shumë shpesh, prandaj kërkoj që ne si kuvend me e gjete një mënyrë që të mbulojmë këto shpenzime, pasi që nxënësi është pajisur në mënyrën më të shpejtë me pasaportë dhe me dokumente të tjera.
**Ali Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, fillimisht më lejoni të i urojë tre kuvendarët e rijnë për marrjen e detyrës, ju urojmë shumë suksese. Desha të ngris një çështje e cila është shumë me rëndësi, komuna e Rahovecit në bashkëpunim me KRU-Gjakovën ka e ka pasur një plan për ndërprerjen e gypit në Gradish, dhe pastaj të bëhet një qasje e re nga a e fshatit Meqë në Radoniq, ku do të mundësonte furnizimin me ujë të pijes nga Gexha deri në Kramovik nga po ky gyp. Me këtë do të eliminoheshin reduktimet në Komunën e Rahovecit qoftë në fshat qoftë në qytet, por ajo që më intereson mua ta di është se deri ku ka shkuar kjo punë, sepse tani sezona e verës është duke u ofruar dhe mundësitë për reduktime janë shumë të mëdha për furnizim me ujë.
**Florida Bajraktari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, për këtë propozim të cilin dua ta japë tani kam biseduar edhe me Drejtorin e Financave. Para disa dite Komuna e Suharekës e kishte marr një vendim që të gjitha gratë ose nënat e Komunës së Suharekës të cilat lindin në QKMF—në e Suharekës të subvencionohen me shumën prej 200.00 €. Kishte me qenë mirë që edhe ne të marrim një vendim të tillë, por së pari le të merret ky propozim dhe le të shqyrtohet më pas nga Kryetari i Komunës, ku do të shikohen kushtet financiare, nëse nuk kemi mundësi këtë vite diçka të bëjmë atëherë kishte me qenë mirë që kur të bëhet vitin e ardhshëm planifikimi i buxhetit, të planifikohet edhe një buxhet shtesë ku komuna jonë do i subvencionojë gratë dhe nënat tona të cilat lindin në QKMF-në e Rahovecit me një shumë prej 200.00 € ose 250.00 €.
**Hanalora Hoti** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem rreth listës që është publikuar për ndarjen e bursave për student, sa kam mundur unë të shohë në këtë listë ka pasur përfitues të cilët nuk kanë qenë meritorë dhe me baza politike. Në këtë listë ka studentë që janë përsëritës të vitit radhazi për tre vite, dhe këtë studentë kanë përfituar bursë. A është ky një demotivim për të tjerët të cilët kanë aplikuar dhe janë meritor por nuk e kanë emrin në këtë listë, a mendoni që i keni përfillur kushtet të cilat vetë i keni paraparë.
**Ali Zhuniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetjet e mija kanë të bëjnë me orientimin e drejtorive ku e kemi mbajtur një trajnim në kuadër të OSBE-së, ndër prioritetet e komunës kanë qenë që së paku drejtoritë përkatëse ose më të rëndësishme në baza tremujore të japin llogaridhënie karshi kuvendit,

por unë jam duke parë që edhe pyetjet kur jemi duke i bërë ka hezitime të ju përgjigjen, disa nga drejtorët e lëshojnë sallën e kuvendit mu në kohën e pyetjeve, një ndër pyetjet që është bërë për drejtorin e shëndetësisë ku ai vazhdimisht e ka liruar sallën e kuvendit. Është për keqardhje sepse ka qenë dita botërore e kancerit me 4 shkurtë, ku kam thënë se z. Vehapi në mandatin e vetë e ka praktikuar një organizim në bashkëpunim me institutin Onkologjik për vetëdijesimin e grave të cilat janë prekur me kancer, kurse drejtori ka hezituar të mirët me këtë desha ta di pse nuk ka ndodhur kjo. Meqenëse jemi në regjion të Gjakovës i kam kërkuar që në bashkëpunim me spitalin e Gjakovës të merë masa për organizimin e kësaj dite. Po ashtu kishte me qenë mirë që të na përgatit një raport tre mujor për Drejtorin e Shëndetësisë sepse janë duke na u paraqitur mjaftë probleme në këtë drejtori. Po ashtu dua një shpjegim nga Drejtori i Bujqësisë sepse kryeministri i Kosovës vazhdimisht e ka përmendur si në debate televizive qoftë në debate publike se subvencionimi prej 5 milion eurove do të filloj të zbatohet shumë shpejtë, dua ta di se në cilën fazë jemi pasi banorët janë duke pritur këto pagesa.

**Refki Kryeziu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, pyetje ime shkon për Drejtorin e Shërbimeve Publike, dua ta di se deri ku ka shkuar puna e ndriçimit publik në fshatin Xërxë, nga dhjetori i viti të kaluar është punuar në një pjesë, por tani punimet janë ndalur, a keni ndonjë periudhë kohore se deri kur do të përfundoj ndriçimi publik në fshatin Xërxë.

**Fehmi Cena** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua ta ngrisë një çështje sa i përket trashëgimisë kulturore dhe historike që i dedikohet direkt Drejtorisë për Kulturë, rini dhe sport, para dy jave është rrënuar një shtëpi në qytetin e Rahovecit, konkretisht tek lagjja Sheshi i Republikës. Kjo shtëpi ka pasur një strukturë dhe një arkitekturë të vjetër mesjetare dhe antike nga guri dhe rasat, mendoj se ka pasur peshën e trashëgimisë kulturore dhe historike. Ne kemi thënë se këto objekte që janë të pakta dhe që janë në shkatërrim e sipër të evidentohen dhe të mirën nën mbrojtje, kjo për faktin se e kanë rëndësinë vetë historike dhe të kulturës kanë rëndësinë edhe turistike për qytetin e Rahovecit. Është mirë që këto objekte të evidentohen nga DKRS-ja dhe të merren nën mbrojtje, nëse ka nevojë që të bëhet restaurimi i tyre le të kërkohet ndihma nga niveli qendrorë. Po ashtu kam një pyetje për Drejtoreshën e DKRS-së, a janë të evidentuara këto objekte me karakter të trashëgimisë kulturore dhe historike, pra a ka një regjistër se cilat janë dhe ku janë. Jam i vetëdijshëm se është ndarë një pjesë të buxhetit buxhet për trashëgimin kulturore dhe historike për vitin 2019, diku rreth 30,000.00 €, në mbledhjet e kaluara ne kemi kërkuar që ky buxhet të ritet sepse ky që është nuk mjafton, por është mirë që të gjenden edhe format që këto objekte të trashëgimisë kulturore dhe historike të ruhen.

**Kryetari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, do përpiqem të ju përgjigjem atyre pyetjeve që më janë adresuar mua. I nderuar z. Ali Zhuniqi në mbledhjen e datës 2 prill do të dihet saktësisht se në çfarë përqindje do të kompensohen fermerët, pastaj do të zhvillohen aktivitetet të cilat kanë për qëllim kompensimin e dëmeve për shkak të reshjeve dhe breshëritë që ka ndodhur vitin e kaluar, i kuptoj edhe bujqit që janë shqetësuar por duhet të dinë se për herë të parë është duke ndodhur që të paguhen dëmet e fermerëve edhe pse e dimë që nuk ka sigurime shëndetësore etj. zotimi është që të kompensohen të gjitha dëmet, vlera e të gjitha dëmeve në tre periudha është më shumë se pesë milion e gjysmë, raporti i përgatitur nga komisionet tona është vlerësuar si raporte profesional, mendoj se pagesat do të bëhen me rata sepse nuk e besoj se do të ketë mundësi ministria të i bëjë gjithë pagesën e dëmeve. Kurse sa i përket pyetjes së z. Fehmi Cena, është e vërtet i nderuar se e kemi një kontratë për restaurimin e objekteve dhe monumenteve të vjetra, kontrata është lidhur vitin e kaluar dhe vazhdon edhe këtë vit. Po ashtu e kemi edhe një listë të objekteve dhe monumenteve të trashëgimisë e cila është në institutin e mbrojtjes së monumenteve, ata e kanë një fond, pastaj është këshilli i Kosovës për trashëgimi kulturore ku mbështesin aktivitete të tilla që kanë për qëllim ruajtjen ose mbrojtjen e monumenteve të traditës, kulturës dhe të historisë. Ju besoj se e dini të gjithë se ne kemi një sfidë kur ka të bëjë me prona private, sepse nëse nuk është në mbrojtje duhet një komunikim me Ministrin e Kulturës që të futet fillimisht në mbrojtje, pastaj ka edhe një situata që nëse nuk është në mbrojtje pronarët privatë nuk mërziten fortë për këtë sepse ata kanë planet e tyre, kurse ne nuk po kemi mekanizma ligjorë të mjaftueshëm që ti ndalojmë për deri sa ato shtëpi nuk gjenden në listën për

mbrojtje të trashëgimisë kulturore dhe historike. Ne së bashku me Drejtoreshën e DKRS-së do e shikojmë edhe një herë listën dhe do ta verifikojmë se a gjendet në listë ajo shtëpi që ti e ceke. E nderuara znj. Mirjeta Krasniqi, unë sot do ja ndajë shumën prej 500 € sepse 500 € ja kam ndarë ditë më parë, por ideja është kjo e nderuar, sot ka shumë shoqata ose organizata të cilat organizojnë gara, pyetje që unë e shtroj për ta është a marrin përsipër ata diçka rreth këtyre garave apo jo, apo duhet të gjitha shpenzimet të i lihen familjarëve apo komunës. Mendoj se kur të merë përsipër organizimin e një gare së paku duhet të ceket se kaq mjete ne i sigurojmë për fituesit, kështu mënoj unë. Kurse nxënësi le ti kthehet garës sepse unë sapo të përfundoj mbledhja do e mare një vendim për ndarjen e mjeteve për të shkuar në gara, nuk ka qenë ideja që të ja japim ne përgjigjen negative nxënësit fitues, por ideja ka qenë që të japim përgjigje atyre që marrin përsipër organizimin e këtyre garave, sepse siç janë duke organizuar ata gara do i organizojmë edhe ne pasi që ne duhet të i mbulojmë shpenzimet. E nderuara znj. Hanalora Hoti sa i përket ndarjes së bursave ne vetëm dy ankesa i kemi, ne jemi të gëzuar që kemi mbërritur të i ndajmë bursat për student, këto bursa ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe dëshira jonë është që sa më shumë studentë të i përkrahim natyrisht sipas kritereve që i përcakton rregullorja. Por ju nëse keni ndonjë ankesë mundeni të i adresoheni komisionit për ndarjen e bursave, por nga informatat që i kam vetëm dy ankesa kanë ardhur tani për tani. Numri i studenteve që kanë aplikuar për bursa është 174, kurse numri i atyre që kanë përfituar është 92 ose 93 studentë. I nderuar z. Ali Morina ka pyetur për një gyp të ujit që ka filluar të ndërtohet qe 6-7 vite, ka është një investim nga Ministria për Zhvillim Ekonomik dhe KRU- Gjakovës, është e vërtet por të vendosej ai gyp nga Dobidoli në Gradish dhe po të ndodhë ajo ndarja që një pjesë të vije në qytet dhe pjesa tjetër Gradish, Dobidol dhe deri në Çifllak, do të ishte një zgjidhje shumë më e mirë dhe do të ketë një furnizim shumë më të mirë me ujë të pijes si në qytet ashtu edhe në fshatra. I nderuar edhe ne jemi të interesuar që të përfundoj ky projekt sepse do të bënte një zgjidhje shumë më të mirë sa i takon furnizimit me ujë si në qytet ashtu edhe në fshatra. E nderuara znj. Florida Bajraktari të ju them të drejtën edhe neve na ka sfiduar pozitivisht vendimi i Komunës së Suharekës që ti ndajmë mjete për ato nëna që lindin në QKMF-në e Rahovecit, unë për këtë do të diskutoj me drejtorin e financave dhe nëse ne kemi mundësi buxhetore , ku pastaj do të ofrojmë një propozim që bazohet nga kërkesa e juaj dhe do të qesim si pikë të rendit të ditës në kuvend, nëse kemi mundësi buxhetore kisha propozuar që të jetë shuma prej 250.00 €, pra të ja kalojmë Komunës së Suharekës.

**Fehmi Cena** - Në lidhje me pyetjen që e shtrova unë kisha kërkuar nga drejtoria për kulturë rini dhe sport të bëj një listë të objekteve të trashëgimisë kulturore historike që janë në listë nën mbrojtje dhe të na e prezantoj në mbledhjen e ardhshme në mënyrë që ne të shohim se ndoshta ka ndonjë objekt që neve na merr mendja që e meriton të hyjë e ndërsa nuk është në listë, unë për këtë shtëpi që e prezantova në fakt e kam pasur fatin që ta shoh para rrënimit, vërtet ka pasur vlera pas 2 jave e shoh të rrënuar nuk e di a ishte në lisë apo jo, kështu që mund të ketë objekte që nuk janë aty dhe nuk do të thotë që këto brenda vitit të restaurohen, por le të restaurohen me faza, le të hyjnë në listë dhe ne do të punojmë në ngritjen e vetëdijes së qytetarëve.

**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë, sa i përket pyetjes së z. Oruqi QKMF-ja është e obliguar që të zbatoj rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoba në qoftëse është e paraparë të lirohen nga pagesa në rregull, por në rregullore nuk është e paraparë të lirohen nga pagesa.

**Rexhep Oruqi** – Unë e kam fjalën për kategorinë e pensionistëve të invaliditetit, e kemi pasur rastin para 1 jave një person pa një sy i kanë marr 2 € për shërbim vetëm pse nuk e ka moshën 65vjeçare.

**Samir Mustafa** – Atëherë në mbledhjen tjetër do të kemi rregulloren në kuvend për plotësim – ndryshim, pasi që nuk është e paraparë me rregullore.

**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë, sa i përket gypit të ujit të pijshëm unë do të jap një informatë në detale, ai gyp furnizues që është prej Gradishit deri në Dobidol është i asbestit që fatkeqësisht është e ndaluar me rregullore dhe duhet patjetër të rregullohet, ne e kemi bërë një projekt detal me KRU Gjakova që të shkoj nga ana e hekurudhës ai gyp për shkak të rreziqeve në qoftëse shpërthen rrezikohen vendbanime. Ky projekt e ka një kosto prej 1.7 milion € ku kanë kërkuar ndihmë nga ministria e zhvillimit

ekonomik në qoftëse aprovohet këtë vit atëherë fillohet implementimi i projektit. Ne jemi duke punuar edhe në projekte të tjera me dy segmente rrugore ku njëra është në përfundim dhe tjetra pritet të zgjidhet për shkak të problemeve. Sa i përket ndriçimit publik jemi duke i vendosur disa instalime nën tokësore në fshatin Ratkoc vazhdojmë me fshatin Denjë ku nuk kemi pasur investime këto 2 vite të fundit, si të përfundojnë këto do të rikthehemi në Xërxe ku shpresoj që brenda 2-3 muajve të përfundoj projekti i ndriçimit publik.

**Rasim Fazliu** – I nderuar drejtor është mirë që rregulloren të na sillni në mbledhjen e rrallës pasi që mund të ndryshojmë atëherë edhe qytetarët ti gëzojnë të drejtat e tyre.

**Isak Hoti** – Përshëndetje për të gjithë, rregullorja për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba janë duke u diskutuar në nivel shteti, për vet faktin me ndryshimin e ligjit për kundërvajtje dhe gjoba që i kemi brenda kemi mjaftë probleme jo vetëm komuna jonë por edhe komuna tjera, janë disa kode që i kanë vendosur në sistem të ri në ministri, sidomos ministria e financave ku na kanë dal probleme edhe neve, besoj që ministria e financave në bashkëpunim me zyrtar ligjor shumë shpejtë do të hartoj një rregullore, do të sillet si draft dhe pasta në bazë të specifikave të komunave mund të votohet në kuvend.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit për diskutimin e bërë rreth pikës së dytë, kalojmë në pikën e radhës:

**3. Shqyrtimi i bartjes (rialokim) të të hyrave vetanake nga viti 2018 – 2019.**

**Afrim Limani** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ligji i financave publike dhe përgjegjësive përcakton saktë bartjen e të hyrave vetanake prej vitit 2018 në vitin 2019. Shuma e mjeteve të bartura për komunën e Rahovecit të hyrave vetanake janë në total prej 403.221 euro, kjo shumë është mjaftë e mirë dhe relativisht e kënaqshme dhe fal inkasimit të mirë që e kemi pasur gjatë muajit nëntor dhe dhjetor, siç e dini edhe ju janë muaj që mbyllet viti fiskal dhe ato mjete nuk mund të barten në projekte të caktuara por barten prej vitit paraprak në vitin pasues, gjithashtu ka pasur mjete të tjera që për një arsye nuk kanë mundur të realizohen në kuadër të projekteve të caktuara. Këto mjete i kemi bartur në investime kapitale 381.295 euro, ndërsa 21.926 euro i kemi bartur në pozicionin paga dhe mëditja, kryesisht në drejtorinë e shëndetësisë sepse këto mjete vitin e kaluar ne i kemi bartur në kuadër të drejtorisë së shëndetësisë në këtë pozicion të pagave, mirëpo nuk janë realizuar dhe për këtë arsye sipas ligjit ne detyrohemi që mjete ti kthejmë në këtë pozicion. Investime kapitale i kemi shpërndarë në këto mjete: ndërtimi i rrugëve me kupëza Dobidol, Palluzhe, Ratkoc, Gegje, Kramovik dhe Guri kuq në shumën prej 160.807 euro, pastaj intervenime emergjente në infrastrukturë prej 32.997 euro, rregullimi i shtretërve, proçkave dhe lumenjve në komunën e Rahovecit 38.000euro, ndërtimi i shkollës Hoqe dhe Brestoc 69.510euro, ndërtimi i çerdhes në Ratkocë 65.000euro dhe kullimi i tokave bujqësore në Xërxe në shumë prej 15.000euro. Sigurisht që kureshtja e juaj dhe bëni pyetje pse kjo shumë 160.807euro në kuadër të këtij projekti, ju njoftoj të dashur asamblist këtë shumë e kemi bartur sepse ishim të detyruar në këtë formë, unë nga zyra e departamentit të thesarit në kuadër të ministrisë së financave kam marr një shkresë që nëpërmjet thesarit të ekzekutoj këtë pagesë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor ne këtë pikë të rendit të ditës e kemi trajtuar në mbledhjen e Komitetit për politikë dhe financa për alukimin e mjeteve.

**Ali Zhuniqi** – Faleminderit drejtorit për sqarimin ishte shumë i qartë dhe konkret i shpjegoj arsyet dhe disa mangësi të drejtorëve për mos shfrytëzimin e këtyre mjeteve, prapë është fatkeqësi që drejtori i shëndetësisë nuk është prezent të na tregoj përse këto mjete nuk kanë mundur të hyjnë në funksion dhe të këtë përgjegjësi publike sepse është një shumë e madhe që nuk është shfrytëzuar në drejtori të caktuar. Unë kam kërkuar që secili drejtor në bazë 3 mujore të prezantoj raportin e punës në kuadër të trajnimit që e kemi pasur në OSBE herën e fundit. Përse duhet të çrregullohet departamenti i thesarit në kuadër të ministrisë së financave një shumë prej 160.000euro në qoftë se ju nuk ishim në gjendje si drejtori përkatëse ti shfrytëzoni këto mjete.

**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, unë e di që çdo herë bëhet bartja e mjeteve nga viti në vit pasi që kështu krijohen kushtet që nuk mund të shfrytëzohen të gjitha, por drejtori e sqaroji këtë punë, unë në emër të grupit pajtohemi që këto mjete të barten prej vitit të kaluar në këtë vit, por e kam një pyetje për drejtorin. Ne e dimë që bartja e mjeteve bëhet nga viti në vit, përse këtu shkruan që mjetet vetanake të barten nga viti 2017 dhe 2018 për vitin 2019, a kemi pasur bartje sepse thjeshtë kam harruar a ka pasur bartje prej vitit

2017 ne 2018 dhe pse atëherë nuk janë bartur ato të 2017, për ndryshe është normale të bëhet bartja e mjeteve prej vitit në vit për ti shfrytëzuar mjete vetanake.

**Muhnib Durguti** – Faleminderit kryesues unë e falënderoj drejtorin që na i dha sqarime për bartjen e këtyre mjeteve të mbetura, mua më intereson tek kodi 408/ 40 tek rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe proçkave në komunën e Rahovecit, këtu po barten gjithësej 38.000 euro. Pyetje për drejtorin e shërbimeve publike meqenëse ky kod është i përgjithshëm e nuk na jep sqarime se cila proçka dhe lumenj do të rregullohen me këto mjete, a hyn këtu edhe mirëmbajta e shtratit të lumit Dullo, ndoshta po bëhem pak i tepër është hera e katërt që e parashtroj këtë pyetje, tri herë kam kërkuar që të pastrohet shtrati i këtij lumi sepse është në një gjendje kautike, më intereson me bartjen e këtyre mjeteve a është planifikuar mirëmbajtja apo pastrimi i shtratit të lumit dulla?

**Masar Popaj** – Përshëndetje për të gjithë unë i drejtohem drejtorit kështu: tek kodi 45/23.2 tek ndërtimi i rrugëve me kubëza në Dobidol Palluzhe, Ratkoc, Gegje, Kramovik dhe Guri kuq, bartja e mjeteve është 160.807.49 euro që mbesim borxh rreth 18.000 euro, përse nuk likuidohet komplet si borxh edhe këto 18.000euro sikurse tek kodi 40,81,5 tek intervenime emergjente në infrastrukturë 2977.40 të kryhet si borxh komplet dhe bartja e mjeteve është 32.977, tek kodi 40,84,40 rregullimi i shtretërve të lumenjve dhe proçkave në komunën e Rahovecit është një borxh 765.095 ndërsa bartja e mjeteve është 38.000, a nuk mund të bëhen ndryshime tek këto kode të barten mjete dhe të kryhet një projekt si duhet e jo të lëmë pjesë pjesë?

**Afrim Limani** – Do ti përgjigjem të gjitha pyetjeve, për pozicionin e pagave për vitin 2017 nuk janë shfrytëzuar, si do që të jetë kjo shumë prej 403.000 euro është shumë pozitive për ne, sinqerisht po ju them ka ndoshta 5 ose 6 vite komuna e Rahovecit asnjëherë nuk ka pasur aq shumë mjete për ti bartur, sa do ku do kjo shumë të paktën e zbret vlerën e projekteve kapitale, do të thotë obligimin të cilin ne e kemi bartur. Kjo shumë në shëndetësi nuk është realizuar për fat të mirë është pozitive, nuk është realizuar në kuadër të pozicionit të pagave, mjetet tek grandet i kanë mbuluar obligime që i kanë pasur drejtoria e shëndetësisë, këto kryesisht hyjnë në pjesë të mbulimit të kujdestarisë që e kemi pasur, kjo shumë bartet për vitin 2019. Sa i përket shumës 160.000euro ne i kemi shfrytëzuar aq sa kemi pasur mjete që janë pjesë e obligimeve dhe borxheve në kuadër të këtij projekti kemi borxh 258.000euro ndërsa ne i kemi alokuar 78.000euro që jemi të detyruar nga ana e thesarit dhe e kemi lënë pjesën e 10% kur operatori i kryen të gjitha punët pas një viti pjesë e siguracionit një shumë simbolike prej 15.000 euro. Këto mjete nga viti 2017 emërtohen me një numër që e kanë 22 këto të hyra vetanake janë të vitit 2018 numër 21, p.sh do të marr një projekt të caktuar nga viti 2017 ne i kemi bartur në vitin 2018 këto mjete të hyrave vetanake të atij viti për një arsye nuk janë shfrytëzuar p.sh ne i kemi ndarë mjete operatori nuk ka mundur ti kryej punët dhe ato mjete barten në vitin që vjen dhe ato emërtohen një vit mbrapa me numër 22. Pyetja tjetër ishte përse këto mjete nuk janë bartur në tersi, nuk i kemi bartur në tërësi për shkak të siguracionit sa i përket projekteve tjera nuk kemi pasur buxhet të mjaftueshëm dhe jemi munduar të paktën ta zbusim gjendjen e borxheve që e kanë.

**Përparim Krasniqi** – Në kuadër të mirëmbajtjes që e kemi ne si komunë kontratat e mirëmbajtjes së hapësirës publike është edhe pastrimi i lumit Dullo mirëpo është për mbeturina, por për shkak të baltës që po krijohet duhet të ndërhyhet me një kontratë tjetër ku edhe jemi në fazën e lidhjes së kontratës për intervenime emergjente sepse nevojitet makineri për pastrim dhe është vështirë të pastrohet, sa i përket pjesës jashtë lumit dulla ne e kemi kontratën për hapësira publike që e kemi ndarë në 3 pjesë është kompania që duhet të kujdeset ti largoj mbeturina rreth lumit, ne do të kujdesemi për këtë hapësirë të rregullojmë çështjen e mirëmbajtjes.

**Dervish Qadraku** – Në mbledhjen për komitet politik dhe financa e kam dhënë një ide që të bëjmë një parking tek shkolla e vjetër a ju ka bërë përshtypje dhe a e keni menduar në këtë drejtim që të bëjmë parking me këto mjete kemi mundur të bëjmë një mbulim të shpenzimeve sepse nuk janë të mëdha dhe do të bëhej një zgjidhje mjaftë e mirë për qytetar që kanë qasje në komunë apo institucione tjera.

Përparim Krasniqi – ne e kemi në planifikim në kuadër të parkingjeve të reja në qytet, për momentin do të trajtojmë vetëm me zhavorr sepse po krijohet një tollovi sidomos gjatë sezonit të verës, do të shohim edhe mundësit të tjera se çfarë mund të bëjmë pasi që është hapësirë publike komunale.
**Fehmi Cena** - një sqarim z. Qadraku disa herë po e përmend këtë truall për parking, në fakt unë jam në dijeni se aty është folur njëherë që të ndërtohet një shkollë e muzikës, pastaj në këshillin e lagjes është përmendur që të ndërtohet një ambulancë dhe ndërtimi i një parku të gjelbër kështu që duhet pasur kujdes që mos të ngutemi për destinim të asaj pjese ku lagjja me patjetër duhet të merr pjesë në përcaktimin se çfarë do të bëhet me atë pjesë.
**Kryesuesi** – Patjetër që duhet shqyrtuar kjo pjesë dhe të gjitha mundësi. E qes në votim Shqyrtimin dhe bartjen (rialokim) të të hyrave vetanake nga viti 2018 – 2019: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e tretë (3) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës
**4. Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër.**
**Artan Asllani** – Përshëndetje për të gjithë, ne si drejtori e kemi një propozim për dhënien në shfrytëzim të pronës në fshatin Xërxe është një objekt në hyrje të depove të Matrex-it, ky objekt është në gjendje jo të mirë ne e kemi parë të arsyeshme të kem si propozim në kuvendin komunal të jetë objekt në shfrytëzim është një hapësirë prej 187 metra katror në bazë të certifikatës i keni të dhënat, qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës është e cekur në pikën 1 dhe 2 është ruajta dhe rritja e vlerës së pronës komunale. Zhvillimi i aktiviteteve biznesore për zyrat administrative të cilat do të lehtësojnë ushtrimin e veprimtarisë biznesore dhe dhënien e mundësisë tek qytetarët për vetë mësim. Kryesisht afati kohor për dhënien me shfrytëzim të këtyre objekteve e kemi parë të arsyeshme të jetë prej 1deri në 15 vite, ndërsa për procedura ankand publik do të kujdeset drejtoria për ekonomi dhe gjeodezisë, zyrës së prokurimit dhe komisioni i formuar prej 7 anëtarëve nga kuvendi i komunës, pasi që është interes i komunës i ftoj të gjithë asamblist të votojnë këtë pikë të rendit të ditës.
**Rasim Fazliu** – E falënderoj drejtorinë për prezantimin e kësaj pike, unë shoh që ka gabime procedurale është fjala që këtu nuk duhet të vij vendimi, vendimi bëhet pasi të kryhet mbledhja kuvendi merr vendim pastaj e bëjnë vendimin dhe e nënshkruajnë ata që janë kompetent dhe vazhdoj më tej puna, edhe pse në faqen tjetër e shoh që është propozim me gjithë atë duhet të jetë propozim vendim jo vendim, në kuvend duhet të vij si propozim vendim arsyeja pse po flasë është kjo p.sh këtu shkruan vendim dhe unë nuk pajtohem me pikën e 4 sepse shkruan afate kohore për dhënien e pronës së paluajtshme të komunale të cekur 1 dhe 2 të këtij vendimi është afat shkurtër në periudhën 5 vite, unë bëj pyetje se kush e merr këtë vendim ne apo ju që e keni sjellë, kuvendi është ai që e merr këtë vendim, ju e keni propozuar 5 ne ndoshta e bëjmë 10 apo 15, prandaj të mos nxitojmë por të rregullojmë mirë dhe herëve të tjera të mos na vijnë vendime por propozim vendime këtu dhe ne e bëjmë diskutimin ne si kuvend e marr një qëndrim për sa do të japim në shfrytëzim këtë pronë gjithsesi përmes ankandit publik dhe kështu shkon puna më mbarë dhe më mirë, këto janë vërejtjet e mia dhe tek pika 1 shkruan dhe merret vendimit është mirë të hiqet shkronja t sepse po i prishet kuptimi. Për fat të mirë qeveria lokale ka të drejtë propozimi por ne jemi ata që pajtohemi ose e zgjasim apo e shkurtojmë atë propozim që e ka dhënë qeveria komunale.
**Fehmi Cena** – Ne i vlerësojmë pozitivisht këto iniciativa kur prona komunale jepet në shfrytëzim të qytetarëve për arsye se është pozitive dhe e dobishme për të dy anët, për komunën sepse krijon të hyrat vetanake por në anën tjetër edhe për qytetarët tanë sepse krijohen vendet e lira pune. Unë i inkurajoj pushtetin lokal, drejtoritë përkatëse që ti identifikoj sa më shumë prona komunale të tilla si objekte, truall që ti jepet në shfrytëzim qytetarëve, sa i përket asaj vërejtjes që e patë z. Fazliu tek pika e 4 unë propozoj që të jetë në periudhën 5 vjeçare me të drejtë vazhdimi nëse punët shkojnë mirë pagesa është me rregull, pra të ketë mundësi vazhdimi pasi që është periudhë prej 1deri në 15 vite natyrisht duhet të ketë specifikat ku mund të vazhdoj biznesi i njëjtë në atë vend apo objekt.
**Masar Popaj** – Kjo ka të bëj me një parcel të vogël apo objekt me sipërfaqe prej 187 metra katror është objekt për shfrytëzim kështu që në këto parcela në Xërxe një vend i quajtur Skaja i kemi thënë për 15 vite

për shfrytëzim para 2 muajve dhe është mirë kur jepet një parcelë të jepet për 15 vite, p.sh Agro Celines i kemi dhënë për 15 vite.

**Refki Kryeziu** – Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në fshatin Xerxe posaçërisht një sipërfaqe e madhe propozimi im është që të mos jepet në shfrytëzim më shumë se 1 vit arsyeja është mos mund të na jepet ndonjë mundësi e investimi të jashtëm për ndërtimin e ndonjë biznesi që të punësohen qytetarët tanë, ky është mendimi im meqenëse komuna jonë ka shumë pak prona.

**Dervish Qadraku** – Duhet të jap mendimin tim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, ideja e dhënies së pronës së komunës individëve apo organizatave të ndryshme këtu që janë në komunën tonë apo më tej është mirë sepse ato rinë kot aty dëmtohen dhe qytetarët nuk kanë mundësi ti shfrytëzojnë ato, këto ide mua më pëlqejnë po ashtu kam vërejtje tek vendimet unë e kam përshtypjen që jeni duke përtuar që ti përshkruani edhe një herë vendimet pasi që është propozim vendim dhe nuk mund të kalohet kështu sepse ne kemi vërejtje si p.sh tek pika e 4 dhënia në shfrytëzim kujtdo qoftë por periudha 3,4 vjeçare është e pamjaftueshme për investitorin sepse ai duhet të investoj që të aftësoj atë objekt dhe është problem që ai të investoj për 5 vite e pastaj të vij dikush tjetër, unë mendoj që duhet të jepet në periudhë prej 10 vite apo 15 vite pa të drejtë vazhdim kontrate.

**Fehmi Hoxha** – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju kryetarin, nënkryetarin, kuvendar, ekzekutivin, mediat dhe gjithë të pranishëm. Së pari dua ti them drejtorit që herën tjetër mos të del vetëm me kopje të planit si është mirëpo duhet të jetë ortofoto, pasi që u konsultova në bazë të numrit të kadastrales dhe skicës normal që askush nga ne nuk e kemi opinionin se për cilën parcel bëhet fjalë pasi që komplet parcela i kemi aty e bëhet fjalë për një pjesë shumë të vogël, për të ardhmen është mirë pak sqarime të kemi. Këtu janë diskutuar disa herë disa propozime po ndërlidhem me drejtorin ti mundësojmë që të marrim një vendim 5 vite me mundësi vazhdimi ligji e përcakton ndryshe. Pas ligjit dhënia e pronave komunale duhet të përcaktohet afatshkurtër dhe afatmesëm, këtu është e përcaktuar afatshkurtër deri sa, afatmesëm dhe afatgjatë kështu që nuk ka të drejtë me mundësi vazhdimi por të përcaktohet për sa vite. Rreth propozim vendimit që është diskutuar këtu bëhet propozim-vendimi del në komitet për politik dhe financa prej anës së kryetarit dhe kur vjen në kuvend këtu shndërrohet në vendim pas marrjes së vendimit, nuk bën ne këtu të diskutojmë propozimin është vendimi i komitetit për politik dhe financa pa marr parasysh a ka pasur pëlqimin paraprak apo jo kalon direkt në kuvend kjo është e rregulluar kështu.

**Kryesuesi** – Faleminderit shumë i nderuar për kontributin e dhënë. E qes në votim vendimin për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër: Konstatoj se me 21 vota për, 2 kundër dhe asnjë abstenim aprovohet pika e katërt (4) e rendit të ditës, kalojmë në pikën e 5 të rendit të ditës

**5. Shqyrtimi i Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve.**

**Isak Hoti** – Me datën 18 Mars është mbajtur debati publik për rregulloren për realizimin e të drejtat e fëmijëve nuk pa pasur asnjë sugjerim, ndryshim apo plotësim pos për qendrën për punë sociale që i ka dhënë rekomandimet e veta, tek neni 6.6, 6.10, 7.2, 8.3, neni 9 pika e 3, 10 pika 2.5 të gjitha këto janë rekomandime që i ka dhënë qendra për punë sociale neni 11.1 dhe 11.4 të gjitha procedurat kanë shkuar me rregull ka mbetur vetëm të votohet në kuvend, kush ka ndonjë propozim, plotësim në këtë drejtim, por ju kisha lutur që drejtpërdrejtë në dispozitë, pikë apo nen e kemi më lehtë të përmirësojmë.

**Rasim Fazliu** – E falënderoj z. Isak Hoti që na i dha sqarime për këtë draft rregullore për realizimin e të drejtave të fëmijëve, unë e di që kjo draft rregullore ka kaluar në debat publik, a ka pasur qytetar dhe a ka pësuar ndryshime apo propozime kjo rregullore.

**Isak Hoti** – Të jemi realist në këtë drejtim ju e di që njerëz pretojnë të dalin, i kemi pasur të qendrës për punë sociale e kemi kryer këtë obligim ligjor.

**Kryesuesi** - E qes në votim Draft Rregullores për Realizimin e të Drejtave të Fëmijëve: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e pestë (5) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

**6. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit për dalje në debat publik të draft rregullores rreth mënyrës dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve MEZAHIR ISMA në Rahovec.**

**Isak Hoti** – Pas kërkesës së kuvendarëve për draft rregullore rreth mënyrës dhe kushteve për shfrytëzimin e palestrës ne kemi marr modele prej komunave tjera, janë disa shifra dhe çështje të cilat kanë nevojë për debat sidomos tek neni 11 tek e drejta e sponzorizimit dhe e reklamave, ne i kemi vendosur disa shifra por ju jeni ata që vendosni, në qoftëse ka nevojë për ndonjë ndryshim apo plotësim deri tek debati publik ju kisha lutur që ti sjellin sepse me të vërtet ka shumë peshë dhe rëndësi.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Hoti, fat i mirë që edhe ne kemi një palestër dhe të rinjtë tanë kanë ku ti zhvillojnë aktivitetet e tyre sportive.

**Ali Morina** – Kjo rregullore është mirë që është sjellë në kuvend dhe tashmë po merr formën dhe mënyrën e organizimit dhe shfrytëzimin e palestrës uroj dhe shpresoj që shumë shpejtë do të vij rregullorja për shfrytëzimin e palestrës dhe sallave të edukatës fizike nëpër shkolla, besoj që komunitetit sportiv do të jep kontributin më të madh në këtë fushë mirëpo unë e kam një vërejtje tek neni 13 pika 1.4 tek shuma e pagesave për shfrytëzim në qoftëse një grupacion donë të shfrytëzoj për një orë palestrën pagesa është 15euro pa ndriçim dhe 20euro me ndriçim konsideroj se është mirë që të ceket se sa është shuma kur e shfrytëzon me ngrohje sepse e dimë që ngrohja e ka një kosto shumë të lartë, apo kjo pikë me pagesë prej 20 euro është me ndriçim dhe ngrohje.

**Kryesuesi** - E qes në votim Vendimin për dalje në debat publik të draft rregullores rreth mënyrës dhe kushtet e shfrytëzimit të palestrës së sporteve MEZAHIR ISMA në Rahovec: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e gjashtë (6) e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës

**7. Informatë mbi menaxhimin e aseteve komunale të komunën e Rahovecit.**

**Artan Asllani** – Siç e dini komuna e Rahovecit ka pasur një problem të kah hershëm në menaxhimin e aseteve komunale, me rekomandim të zyrës së auditorit kombëtar për vitin 2017 dhe rekomandimeve të vazhdueshme për vitin 2018 si problem ka qenë regjistrimi i aseteve komunale, me propozim të drejtorisë së ekonomisë iu kemi drejtuar kryetarit të komunës z. Smajl Latifi të cilit i kemi propozuar ngritjen e disa komisioneve që merren me regjistrimin e pasurive jo financiare. Në vazhdim ju kam paraqitur në mënyrë të tabelave përshkrimin, artikuj dhe vlerën. Inventari në administratë në vitin 2018 ishte rreth 4472 artikuj dhe vlera e këtyre aseteve jo financiare ishte 128.384 euro, po ashtu është edhe inventari nëpër shkolla komplet komunës së Rahovecit ishte 19.764 artikuj dhe vlera e të gjitha këtyre aseteve ishte rreth 287.797.40 euro, po ashtu inventari i QKMF,AMF, ku në total komplet për vitin 2018 vlera e këtyre aseteve financiare është 470.115.40 euro. Dua të ndalem në këtë pikë pasi që tërë këto artikuj dhe vlera është shumë e vogël në mjete monetare, në kuvendin komunal ka mjaftë asete në të gjitha institucione që komisioni kur e bën vlerësimin e bën me anë të katalogut, dhe ne në momenti që bëhet blerja tek jo vlera financiare shkon deri në 20% vlera e amortizimit të pajisjeve, mjeteve dhe gjë sendeve tjera, ku vlera e tyre shkon deri në 5% vlera e amortizimit, në bazë të konstatimit të komisionit vlera reale është 470.115.40 euro, ndërsa gjatë viti jemi përkujdesur që pasi kemi bërë regjistrimin dhe vlerësimin e kemi një sistem të posaçëm prej ministrisë së financave e kemi obligim që këto asete ti vendosim nëpër programe që quhet E-Pasuria është program i veçantë që kemi bërë dalje të të gjitha këtyre aseteve që janë edhe barkode që janë shpërndarë për çdo artikuj, në bazë të numrit të barkodit nga auditorit të jashtëm apo të brendshëm që shprehin interes mund të bëjnë verifikimin e artikullit. Gjatë vitit 2018 kemi pasur që rekomandim të kah hershëm nga auditori i jashtëm për regjistrimin e tokave në komunën e Rahovecit, vitet më parë kanë punuar misione të ndryshme por nuk kanë arritur të bëjnë regjistrimin e komplet tokave bujqësore. Ne gjatë vitit 2018 kemi punuar pa ndal ku kemi arritur regjistrimin e 460 parcela të tokave me vlerë prej 16milion euro, por e kemi bërë në mënyrë tabelare komplet asete për vitin 2018. Në objekte arsimore e kap një vlerë prej 14.106.042.53 euro në objekte sportive, vetura, objekte shëndetësore d.m.th deri më 31 dhjetor 2018 komplet pasuria e komunës së Rahovecit e kap një vlerë 81.807.030.30euro.

**Rasim Fazliu** – E falënderoj drejtorin për këto të dhëna, unë mendoj që është kryer një punë mjaftë e mirë se ndër vite ishte rekomandim i zyrës kombëtare të auditimit regjistrimi i aseteve komunale dhe është mirë

që drejtoria për ekonomi zhvillim dhe turizëm ka formuar ka formuar komisione dhe e kanë bërë regjistrimin e aseteve komunale dhe vlerësimin e pasurive të paluajtshme dhe nuk kemi vërejtje nga auditori i përgjithshëm. Desha ti drejtohem drejtorit ne këtu i kemi disa shifra që i keni dhënë por a janë regjistruar dhe vlerësuar të gjitha prona apo ka edhe prona tjera që nuk keni mundur të arrini të bëni regjistrimin e tyre.
**Artan Asllani** – Për vitin e kaluar kemi mundur ti vlerësojmë 460 parcela, ndërsa për këtë vit besoj që do të përfundojnë deri në 6 mujorin e parë
**Fehmi Cena** – Një ndërhyrje të vogël ne edhe në mbledhjen e komitetit për politik dhe financa kemi bërë pyetje të njëjtë dhe kemi marr përgjigje të njëjtë, por është mirë që në këtë dokument të ketë një pasues me shkrim që puna nuk është kryer në tërësi por vazhdon puna edhe në të ardhmen sepse ky është një raport që në të ardhmen mund të sjellë paqartësi pas një viti.
**Kryesuesi** – Atëherë në koordinim me anëtar të kuvendit hiqet nga rendi i ditës pika e 8 dhe 9 e rendit të ditës, kalojmë në pikën e rrallës.
**10. Informatë mbi menaxhimin e situatave në mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve gjatë sezonit dimërorë**
**Përparim Krasniqi** – Do të jap disa informata edhe pse të gjithë i keni raporte të shkruara por do të flas për situata që kanë ndodhur gjatë reshjeve të borës ku kanë filluar në janar, kemi dy kompani që kujdesen për mirëmbajtjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror ku i kemi të ndarë në lloto dhe janë të specifikuar rrugë me sasi të kripës që janë mirëmbajte.
**Kryesuesi** – Ju faleminderit kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës.
**11. Shqyrtimi dhe aprovimi i Propozim vendimit për Nismën e bashkëpunimin ndërkomunal.**
**Kryesuesi** – Kryetari i komunës e dha sqarimin sa i përket pikës së njëmbëdhjetë, nëse keni diçka për të shtuar fjala është për ju. **Nëse** nuk keni atëherë e qes në votim Propozim vendimit për Nismën e bashkëpunimin ndërkomunal. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e njëmbëdhjetë (11) e rendit të ditës. Kuvendar të nderuar ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë, mirupafshim në mbledhjet e radhës.

**Mbledhja e kuvendit ka përfunduar në ora 12:10**

**01 Nr.**
**Rahovec, 29.03.2019**

**Procesmbajtësi**

**Skender Hamza**

**K R Y E S U E S I**

**Afrim Dina**

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo
Komuna e Rahovecit / Opština Orahovac / Municipal of Rahovec

Drejtoria për Buxhet dhe Financa
Odeljenje za Finansije i Budzet
Department of Finance and Budget




# RAPORT FINANCIAR

## JANAR – MARS 2019

**PRILL 2019**

## Përmbajtja

HYRJE ....................................................................................................................3

1. TË HYRAT VETANAKE....................................................................................................4

1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2018/2019.........................................4
1.2 Të hyrave vetanake të realizuara në baza mujore 2018/2019 dhe krahasimi i tyre. ............................4
1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2012-2019. ....................................4
1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2018/2019. ...............4
1.5 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara sipas kodeve ekonomike 2018/2019 ..........................5

2. TATIMI NË PRONË ..........................................................................................................6

2.1 Planifikimi dhe realizmi i tatimit në pronë 2018/2019 .....................................................................6

3. REALIZIMI I BUXHETIT ...................................................................................................7

3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë ......................................................................................7
3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike ........................................................7
3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve ..........................................................................................9
3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike ...............................................................................12
3.5 Shërbime Komunale .......................................................................................................................13

## HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsimi dhe Shkencë për periudhën Janar – Mars 2019, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave& mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetjake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjobat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me te njëjtën periudhë Janar-Mars të vitit 2018/2019

Buxheti i Komunës për vitin 2019, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2019, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërsishme,
- Shiqimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
- Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,
- Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.

❖ Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:

- Realizimi i të hyrave vetjake-komunale sipas burimeve,
- Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
- Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

# 1. TË HYRAT VETANAKE

## 1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2018/2019

| Emërtimi | Plani vjetor i të hyrave për 2019 | Realizimi 2018 (Jan-Mars) | Realizimi 2019 (Jan-Mars) | Progresi ndaj planit vjetor 2019 | Progresi ndaj realizimit 2018 (01-03) |
|---|---|---|---|---|---|
| | A | B | C | D=(C/A)*100 | E=(C/B)*100 |
| Të hyrat | 1,168,767.00 | 251,324.88 | 246,957.39 | 21.13 | 98.26 |

**-Verejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2018 dhe 2019 janë pa gjobat e trafikut dhe gjykatave.**

## 1.2 Të hyrave vetanake të realizuara në baza mujore 2018/2019 dhe krahasimi i tyre.

| Nr | Përshkrimi | Të hyrat vetanake | | | Indexi | Indexi |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Të realizuara 2018 | Të planifikuara 2019 | Të realizuara 2019 | 5/3 | 5/4 |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| 1 | Janar | 71,296.21 | 97,397.33 | 67,441.16 | 0.946 | 0.692 |
| 2 | Shkurt | 79,441.98 | 97,397.33 | 101,728.36 | 1.281 | 1.044 |
| 3 | Mars | 100,586.69 | 97,397.33 | 77,787.87 | 0.773 | 0.799 |
| | Gjithsej : | 251,324.88 | 292,191.99 | 246,957.39 | 0.983 | 0.845 |

## 1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2012-2019.

| Periudha | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 61,123.60 | 47,936.41 | 59,440.11 | 53,093.33 | 65,258.72 | 71,296.21 | 67,441.16 |
| Shkurt | 76,384.19 | 69,513.45 | 63,104.60 | 72,122.01 | 53,970.89 | 79,441.98 | 101,728.36 |
| Mars | 69,604.65 | 71,192.41 | 73,504.67 | 107,024.34 | 123,917.27 | 100,586.69 | 77,787.87 |
| GJITHSEJ | 207,112.44 | 188,642.27 | 196,049.38 | 232,239.68 | 243,146.88 | 251,324.88 | 246,957.39 |

## 1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2018/2019.

**Gjobat në trafik në baza mujore**

| Periudha | Gjobat në trafik 2018 | Gjobat ne trafik 2019 | Ndryshimi 2019 - 2018 | % 19/ 18*100 |
|---|---|---|---|---|
| Janar | 7,410.00 | 10,566.00 | 3,156.00 | 42.59 |
| Shkurt | 4,765.00 | 13,285.00 | 8,520.00 | 178.80 |
| Mars | 5,250.00 | 10115 | 4,865.00 | 92.67 |
| GJITHSEJ | 17,425.00 | 33,966.00 | 16,541.00 | 94.93 |

**Gjobat e gjykatës baza mujore**

| Gjobat e gjykatave 2018 | Gjobat e gjykatave 2019 | Ndryshimi 2019 - 2018 | % 19/18*100 |
|---|---|---|---|
| | 1,870.00 | 1,870.00 | N/A |
| | 1,342.70 | 1,342.70 | N/A |
| 6,395.00 | | -6,395.00 | 0.00 |
| 6,395.00 | 3,212.70 | -3,182.30 | 50.24 |

**Të hyrat e rregullta, Gjobat e Gjykatave, Gjobat në trafik 2018/2019**

| Realizimi për vitin | 2018 | 2019 | Krahasimi 2019/2018 |
|---|---|---|---|
| Te hyrat e rregullta | 251,324.88 | 246,957.39 | -1.74 |
| Gjobat e gjykatave | 6,395.00 | 3,212.70 | -49.76 |
| Gjobat ne trafik | 17,425.00 | 33,966.00 | 94.93 |
| Te hyrat nga pyjet | 0.00 | 0.00 | N/A |
| GJITHSEJ | 275,144.88 | 284,136.09 | 3.27 |

**Paraqitja Grafike të hyrat 2018/2019**




| | Te hyrat e rregullta | Gjobat e gjykatave | Gjobat ne trafik | te hyrat nga pyjet | Totali |
|---|---|---|---|---|---|
| 2018 | 251,324.88 | 6,395.00 | 17,425.00 | 0.00 | 275,144.88 |
| 2019 | 246,957.39 | 3,212.70 | 33,966.00 | 0.00 | 284,136.09 |
| % 2019/2018 | -1.74 | -49.76 | 94.93 | 0.00 | 3.27 |

## 1.5 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara sipas kodeve ekonomike 2018/2019

| Kodet | Përshkrimi | Planifikimi për 2019 | Realizimi 2018 | Realizimi 2019 | Ndryshimi në vlere 2019-2018 | Krahasimi 2019/2018 në % | Krahasimi realizim /planifikim në % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 40110 | Tatimi ne prone dhe tatimi ne toke | 388,767.00 | 112,474.80 | 103,431.27 | -9,043.53 | -8.04 | 26.60% |
| 50002 | Taksa rrugore | 35,000.00 | 19,700.00 | 19,240.00 | -460.00 | -2.34 | 54.97% |
| 50009 | Taksa komunale për leje ndërtimi | 35,000.00 | 13.00 | 11.00 | -2.00 | -15.38 | 0.03% |
| 50010 | Taksa për demolim | 2,000.00 | 229.00 | - | -229.00 | -100.00 | 0.00% |
| 50011 | Taksa për rexhistrimin e trashegimisë | 35,000.00 | 6,451.00 | 6,110.00 | -341.00 | -5.29 | 17.46% |
| 50012 | Taksa për ndrrimin e destinimit te shfrytzimit të tokës | - | 200.00 | 10,058.00 | 9,858.00 | 4,929.00 | N/A |
| 50013 | Taksa për certifikatat e lindjes | 45,000.00 | 17,485.00 | 13,856.00 | -3,629.00 | -20.75 | 30.79% |
| 50014 | Taksa për certifikatat e kurorëzimit | 14,000.00 | 1,400.00 | 1,180.00 | -220.00 | -15.71 | 8.43% |
| 50015 | Taksa për certifikatat e vdekjës | 4,500.00 | 388.00 | 401.00 | 13.00 | 3.35 | 8.91% |
| 50016 | Taksa për certifikatat e tjera të ofiqarisë | 18,000.00 | 293.00 | 271.00 | -22.00 | -7.51 | 1.51% |
| 50018 | Taksa e fotokopjimit te dokumenteve | - | - | - | 0.00 | N/A | N/A |
| 50019 | Taksa të tjera administrative | 36,500.00 | 29,457.43 | 14,819.50 | -14,637.93 | -49.69 | 40.60% |
| 50020 | Taksa për pjesëmarrje në tender | - | - | - | 0.00 | N/A | N/A |
| 50026 | Takse per legalizimin e objekteve | 38,000.00 | - | - | 0.00 | N/A | 0.00% |
| 50045 | Leje mjedisore komunale | - | - | 3,244.50 | 3,244.50 | N/A | N/A |
| 50101 | Gjobat në trafik | 43,600.00 | 17,425.00 | 33,966.00 | 16,541.00 | 94.93 | 77.90% |
| 50102 | Gjobat e gjykatës | 55,000.00 | 6,395.00 | 3,212.70 | -3,182.30 | -49.76 | 5.84% |
| 50104 | Gjobat nga inspektoriati | - | - | 85.00 | 85.00 | N/A | N/A |
| 50201 | Licencat për aktivitete individuale dhe të lira | - | 209.00 | 120.00 | -89.00 | -42.58 | N/A |
| 50205 | Licencat per pranim teknik të lokalit | - | - | - | 0.00 | N/A | N/A |
| 50206 | Licencat për shërbimet profesionale | - | - | - | 0.00 | N/A | N/A |
| 50029 | Takse per ushtrimin e veprimtarise | 75,000.00 | 20,861.00 | 17,467.00 | -3,394.00 | -16.27 | 23.29% |
| 50290 | Licenca të tjera për afarizëm | - | - | - | 0.00 | N/A | N/A |
| 50401 | Shitja e shërbimeve | 4,000.00 | 360.00 | 372.00 | 12.00 | 3.33 | 9.30% |
| 50403 | Të hyrat nga shitja e mallrave | - | - | - | 0.00 | N/A | N/A |
| 50405 | Shfrytëzimi I pronës publike | 34,500.00 | 5,221.53 | 2,935.03 | -2,286.50 | -43.79 | 8.51% |
| 50407 | Qiraja për vendosjën e objektit tregtar | 55,000.00 | 16,733.62 | 12,442.64 | -4,290.98 | -25.64 | 22.62% |
| 50408 | Qiraja nga objektet publike | 8,000.00 | - | 2,187.34 | 2,187.34 | N/A | 27.34% |
| 50416 | Të hyrat nga shitja e mbeturinave | 140,000.00 | - | | | N/A | 1.56% |
| 50409 | Participimet-qerdhja e femijeve | 10,000.00 | 2,160.00 | 2,210.00 | 50.00 | 2.31 | 22.10% |
| | Participimet-arsimi joformal | 15,000.00 | - | - | 0.00 | N/A | 0.00% |
| 50409 | Participimet-Shendetesia | 50,000.00 | 8,169.50 | 8,289.50 | 120.00 | 1.47 | 16.58% |
| | Participimet-Bujqesia | 8,500.00 | - | 21,041.14 | 21,041.14 | N/A | 247.54% |
| 50503 | Inspektimi I rrespektimit të planit urbanistik | - | 3,115.00 | 3,038.47 | -76.53 | -2.46 | N/A |
| 50504 | Tax per matjen tokes ne teren | 18,000.00 | 6,404.00 | 4,147.00 | -2,257.00 | -35.24 | 23.04% |
| 50409 | Te hyrat nga pyje | - | - | - | 0.00 | N/A | N/A |
| 50214 | Participimet nga qytetaret | 400.00 | - | - | 0.00 | N/A | 0.00% |
| | **GJITHSEJ** | **1,168,767.00** | **275,144.88** | **284,136.09** | **8,991.21** | **3.27** | **24.31%** |

# 2. TATIMI NË PRONË

## 2.1 Planifikimi dhe realizmi i tatimit në pronë 2018/2019

| Periudha | Të planifikuara 2018 | Të realizuara 2018 | Të planifikuara 2019 | Të realizuara 2019 | Përqindja e realizimit 2018 | Përqindja e realizimit 2019 | Krahasimi në % 2019/18 | Nr.i çert. të lëshuara 2018 | Nr.i çert. të lëshuara 2019 | Nr.e faturave të paguara 2018 | Nr.e faturave të paguara 2019 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Janar | 28,333.33 | 30,887.80 | 32,397.25 | 36,115.71 | 109.02 | 111.48 | 116.93 | 1,423 | 1,911 | 721 | 884 |
| Shkurt | 28,333.33 | 38,816.93 | 32,397.25 | 28,729.76 | 137.00 | 88.68 | 74.01 | 2,772 | 1,908 | 1,194 | 772 |
| Mars | 28,333.33 | 44,229.63 | 32,397.25 | 39,958.96 | 156.10 | 123.34 | 90.34 | 1,701 | 1,893 | 1,224 | 986 |
| **Total** | **84,999.99** | **113,934.36** | **97,191.75** | **104,804.43** | **134.04** | **107.83** | **91.99** | **5,896** | **5,712** | **3,139** | **2,642** |

Paraqitja grafike 2019/2018



# 3. REALIZIMI I BUXHETIT

## 3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë)

| Programet(Drejtoritë) | Pagat dhe mëditjet | Mallrat dhe shërbimet | Shpenzimet komunale | Subvencionet dhe transferet | Shpenzimet kapitalet |
|---|---|---|---|---|---|
| Totali (10+21+22+30-99+04) | 1,817,950.40 | 108,807.55 | 51,027.54 | 49,500.00 | 756,396.75 |
| GRANDI QEVERITAR(10) | 1,817,950.40 | 108,807.55 | 51,027.54 | - | 740,649.75 |
| Zyra e Kryetarit | 39,278.75 | 4,782.48 | | | |
| Administrata | 52,260.58 | 11,656.99 | | | |
| Çështje Gjinore | 1,266.50 | | | | |
| Inspekcioni | 17,064.76 | 231.94 | | | 20,000.03 |
| Zyra e Kuvendit Komunal | 23,226.23 | 1,585.54 | | | |
| Buxhet dhe Financa | 17,551.62 | 2,842.14 | | | |
| Shërbime Publike | 6,587.69 | 36,866.44 | 27,361.94 | | 435,373.13 |
| Zjarrëfiksat | 33,660.32 | 335.64 | | | 17,500.00 |
| Zyra për Komunitete | 14,573.01 | 25.21 | | | |
| Bujqësia | 13,717.56 | 1,500.20 | | | 79,686.40 |
| Zhvllimi Ekonomik | 10,681.40 | 237.70 | | | |
| Kadastra dhe Gjeodezia | 13,908.82 | 514.87 | | | |
| Urbanizmi | 9,578.56 | 1,578.05 | | | 32,500.35 |
| Shëndetësia | 220,526.56 | 31,297.58 | 12,392.44 | | 40,857.41 |
| Shërbimet sociale | 21,847.09 | 3,440.29 | 460.95 | | |
| Kulturë,Rini dhe Sport | 14,894.42 | 978.87 | | | 4,732.43 |
| Administrata e arsimit | 11,510.37 | 6,734.62 | | | 110,000.00 |
| Arsimi Parafillor & Qerdhe | 11,368.35 | 2,063.40 | 298.68 | | |
| Arsimi Fillor | 1,013,302.39 | 1,858.12 | 8,045.77 | | |
| Arsimi i Mesëm | 271,145.42 | 277.47 | 2,467.76 | | |
| TË HYRAT VETANAKE--21 | - | - | - | 49,500.00 | 15,747.00 |
| Zyra e Kryetarit | | | | 1,330.00 | |
| Administrata | | | | | |
| Inspekcioni | | | | | 6,000.00 |
| Shërbime Publike | | | | | |
| Zyra për Komunitete | | | | | |
| Bujqësia | | | | | |
| Zhvllimi Ekonomik | | | | | |
| Kadastra dhe Gjeodezia | | | | | |
| Urbanizmi | | | | | |
| Shëndetësia | | | | 8,070.00 | |
| Kulturë,Rini dhe Sport | | | | 40,100.00 | 9,747.00 |
| Arsim dhe Shkencë | | | | | |
| TE HYRAT E BARTURA-22 | - | - | - | - | - |

## 3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike

| Kategoritë Ekonomike | Buxheti sipas planifikimit | Alokimet SIMFK | Shpenzimet | Progresi % me planifikim | Progresi % me alokim |
|---|---|---|---|---|---|
| Pagat dhe mëditjet | 7,537,669.00 | 1,817,950.40 | 1,817,950.40 | 24.12 | 100.00 |
| Mallrat dhe Shërbimet | 1,514,330.00 | 301,074.20 | 108,807.55 | 7.19 | 36.14 |
| Shpenzimet komunale | 255,500.00 | 73,650.20 | 51,027.54 | 19.97 | 69.28 |
| Subvencionet dhe transferet | 250,001.00 | 50,000.00 | 49,500.00 | 19.80 | 99.00 |
| Shpenzimet kapitale | 4,203,391.00 | 1,705,741.00 | 756,396.75 | 17.99 | 44.34 |
| TOTALI | 13,760,891.00 | 3,948,415.80 | 2,783,682.24 | 20.23 | 70.50 |




| | Pagat dhe mëditjet | Mallrat dhe Shërbimet | Shpenzimet komunale | Subvencion et dhe transferet | Shpenzimet kapitale | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet | 1.817.950,40 | 108.807,55 | 51.027,54 | 49.500,00 | 756.396,75 | 2.783.682,24 |
| Alokimet SIMFK | 1.817.950,40 | 301.074,20 | 73.650,20 | 50.000,00 | 1.705.741,00 | 3.948.415,80 |

## 3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve

| Kode | Përshkrimi | Zyra e Kryetarit | | Administrata | | Çështje Gjinore | | Inspekcioni | | Kuvendit Komunal | | Buxhet dhe Financa | | Totali | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tabela A | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 |
| 13131 | Meditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit | - | | | 270.00 | | | | | | 540.00 | | | - | 810.00 |
| 13140 | Shpenzimet e Udhetimit zyrtar jasht vendit | 495.60 | | | | | | | | | | | | 495.60 | - |
| 13142 | Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jasht vendit | 120.00 | | | | | | | | | | | | 120.00 | - |
| 13143 | Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jasht vendit | 35.20 | | | | | | | | | | | | 35.20 | - |
| 13310 | Shpenzimet për internet | | | | | | | | | | | 70.12 | | 70.12 | - |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | | 389.25 | | | | | | | | | | | - | 389.25 |
| 13330 | Shpenzimet postare | | | 115.70 | 262.40 | | | | | | | 5,857.60 | | 5,973.30 | 262.40 |
| 13420 | Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures | 519.08 | 435.76 | | | | | | | | | | | 519.08 | 435.76 |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | | | | | | | | | | 1,000.00 | | | - | 1,000.00 |
| 13450 | Shërbime shtypje- jo marketing | | | | | | | | | | | 1,021.14 | 2,129.59 | 1,021.14 | 2,129.59 |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 356.60 | 218.40 | | 5,975.62 | | | | | | | | | 356.60 | 6,194.02 |
| 13480 | Shpenzimet për Antarësim | 2,000.00 | 2,810.40 | | | | | | | | | 1,815.60 | | 3,815.60 | 2,810.40 |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 624.95 | 60.00 | 1,392.45 | 70.00 | | | 746.70 | | 534.55 | | 1,168.25 | | 4,466.90 | 130.00 |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 94.00 | | 1,774.30 | 1,160.26 | 87.10 | | | | | | | | 1,955.40 | 1,160.26 |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | | | 10,876.80 | 151.38 | | | | | | | | | 10,876.80 | 151.38 |
| 13760 | Dru | | | 1,046.00 | | | | | | | | | | 1,046.00 | - |
| 13780 | Karburant per vetura | 1,186.37 | 793.67 | 825.75 | 115.98 | | | 1,448.15 | 231.94 | 110.36 | 45.54 | 613.67 | 134.55 | 4,184.30 | 1,321.68 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | 75.00 | 75.00 | | 30.00 | | | | | | | 75.00 | | 150.00 | 105.00 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | | | 109.64 | | | | | | | | | | 109.64 | - |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 1,829.00 | | 1,291.00 | 1,495.00 | | | 2,134.00 | | 397.00 | | 512.00 | | 6,163.00 | 1,495.00 |
| 14020 | Mirembajtja e ndertesave | | | 15,910.68 | 2,126.35 | | | | | | | | | 15,910.68 | 2,126.35 |
| 14220 | Botimet e publikimeve | | | 540.00 | | | | 300.00 | | | | 760.00 | | 1,600.00 | - |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik | | | 1,068.24 | | | | | | 690.00 | | | 500.00 | 1,758.24 | 500.00 |
| 14310 | Drekat zyrtare | 1,431.86 | | | | | | | | | | | 78.00 | 1,431.86 | 78.00 |
| 14320 | Drekat zyrtare jasht vendit | | | | | | | | | 23.00 | | | | 23.00 | - |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | 2,475.38 | | 4,972.90 | | | | | | | | | | 7,448.28 | - |
| 14420 | Pagesa-Neni 39.2 LMFPP | | | 2,989.55 | | | | | | | | | | 2,989.55 | - |
| | **Totali** | **11,243.04** | **4,782.48** | **42,913.01** | **11,656.99** | **87.10** | **-** | **4,628.85** | **231.94** | **1,754.91** | **1,585.54** | **11,893.38** | **2,842.14** | **72,520.29** | **21,099.09** |

| Kode | Përshkrimi | Shërbime Publike | | Zjarrëfikësat dhe Inspektimet | | Zyra për Komunitete | | Bujqësia | | Ekonomia | | Kadastra dhe Gjeodezia | | Totali | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tabela B | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 |
| 13131 | Meditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit | | 270.00 | | | | | | | | | | | - | 270.00 |
| 13310 | Shpenzimet për internet | | | | 42.00 | | | | | | | | | - | 42.00 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | | | | 14.43 | | | | | | | | | - | 14.43 |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | | | | | | | 1,562.40 | 1,377.00 | 4,000.00 | | | 305.40 | 5,562.40 | 1,682.40 |
| 13490 | Sherbimet e Varrimit | 8,457.70 | 9,900.00 | | | | | | | | | | | 8,457.70 | 9,900.00 |
| 13501 | Mobilje (me pak se 1000 euro) | | | 951.50 | | | | | | | | | | 951.50 | - |
| 13610 | Furnizime për zyrë | | | | | | | | | 244.10 | 84.00 | 192.50 | 96.00 | 436.60 | 180.00 |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | | | | | | | | 60.13 | | | | | - | 60.13 |
| 13780 | Karburant per vetura | 605.29 | 59.54 | 1,134.21 | 279.21 | 289.38 | 25.21 | 522.72 | 63.07 | 392.42 | 93.70 | 299.42 | 113.47 | 3,243.44 | 634.20 |
| 13790 | Gas natyror | | | | | | | | | | | | | - | - |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | 75.00 | | 170.00 | | | | | | | 60.00 | | | 245.00 | 60.00 |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 341.00 | | 4,197.00 | | | | 232.00 | | 563.00 | | 548.00 | | 5,881.00 | - |
| 14032 | Mirembajtja e auto rrugeve lokale | 15,712.90 | 26,636.90 | | | | | | | | | | | 15,712.90 | 26,636.90 |
| 14210 | Reklamat dhe konkurset | | | | | | | 800.00 | | | | | | 800.00 | - |
| 14220 | Botimet e publikimeve | | | | | 200.00 | | | | | | 200.00 | | 400.00 | - |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | | | | | | | | | | | 2,470.00 | | 2,470.00 | - |
| | **Totali** | **25,191.89** | **36,866.44** | **6,452.71** | **335.64** | **489.38** | **25.21** | **3,117.12** | **1,500.20** | **5,199.52** | **237.70** | **3,709.92** | **514.87** | **44,160.54** | **39,480.06** |

| Kode | Përshkrimi | Urbanizmi | | Shëndetësia dhe Mirëqenie sociale | | Qendra për punë sociale | | Kulturë,Rini dhe Sport | | Arsimi | | Totali | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Tabela C** | **2018** | **2019** | **2018** | **2019** | **2018** | **2019** | **2018** | **2019** | **2018** | **2019** | **2018** | **2019** |
| 13130 | Shpenzimet e Udhetimit zyrtar brenda vendit | | | 123.40 | | | | | | 5,641.20 | | 5,764.60 | - |
| 13133 | Shpenzimet tjera te udhitimit zyrtar brenda vendit | | | | | | | | | | 3,125.62 | - | 3,125.62 |
| 13310 | Shpenzimet për internet | | | | | | | | 156.17 | 153.94 | 176.24 | 153.94 | 332.41 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | | | 1,624.78 | | | | 1,268.38 | | 725.09 | | 3,618.25 | - |
| 13330 | Shpenzimet postare | | | 209.60 | 76.60 | | | | | | | 209.60 | 76.60 |
| 13430 | Shërbime te ndryshme shendetësore | | | | 60.00 | | | | | | | - | 60.00 |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | 110.00 | 252.86 | | | | | | | | | 110.00 | 252.86 |
| 13450 | Shërbime shtypje- jo marketing | | | | | | | | | | 759.00 | - | 759.00 |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 1,000.00 | 1,271.94 | 346.50 | 6,604.08 | | | 350.00 | 291.97 | | | 1,696.50 | 8,167.99 |
| 13470 | Shërbime Teknike | | | 92.00 | | | | 96.00 | | | | 188.00 | - |
| 13501 | Mobilje (me pak se 1000 euro) | | | 4,696.50 | | | | | | 1,444.50 | | 6,141.00 | - |
| 13506 | Pajisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro) | | | | | | | | | 1,572.75 | | 1,572.75 | - |
| 13509 | Pajisje tjera (me pak se 1000 euro) | | | | | | | | | - | 70.00 | - | 70.00 |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 185.45 | | 2,540.30 | 382.80 | | | 2,344.50 | 79.50 | 1,702.70 | 733.80 | 6,772.95 | 1,196.10 |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | | | 26.60 | | | | | 132.84 | 1,389.65 | 2,063.40 | 1,416.25 | 2,196.24 |
| 13630 | Furnizime mjekësore | | | 1,490.37 | | | | | | | | 1,490.37 | - |
| 13640 | Furnizime pastrimi | | | 496.50 | | | | | | 181.00 | 166.55 | 677.50 | 166.55 |
| 13655 | Furnizim me preparate kimike | | | | | | | 252.00 | | | | 252.00 | - |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | | | 15,408.80 | 9,614.31 | 1,359.60 | 1,829.56 | | | 2,149.20 | | 18,917.60 | 11,443.87 |
| 13750 | Qymyr | | | | | | | | | 3,110.49 | | 3,110.49 | - |
| 13760 | Dru | | | | | | | | | 5,758.61 | | 5,758.61 | - |
| 13770 | Derivate per gjenerator | | | | | | | | | 177.58 | | 177.58 | - |
| 13780 | Karburant per vetura | 270.36 | 53.25 | 5,357.46 | 8,603.41 | 196.89 | 500.65 | 207.16 | 213.39 | 372.32 | | 6,404.19 | 9,370.70 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | | | 210.00 | 270.00 | | | | 105.00 | | | 210.00 | 375.00 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | | | 821.28 | 1,405.38 | | 184.08 | 708.00 | | 100.30 | | 1,629.58 | 1,589.46 |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 500.00 | | 7,064.06 | 4,281.00 | 893.00 | 926.00 | 973.00 | | 205.00 | | 9,635.06 | 5,207.00 |
| 14023 | Mirembajtja e shkollave | | | | | | | | | 482.95 | 75.00 | 482.95 | 75.00 |
| 14024 | Mirembajtja e objekteve shendetesore | | | 15,617.36 | | | | | | | | 15,617.36 | - |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve | | | | | | | 96.00 | | 1,500.00 | 95.00 | 1,596.00 | 95.00 |
| 14210 | Reklamat dhe konkurset | | | | | | | 500.00 | | 300.00 | 50.00 | 800.00 | 50.00 |
| 14220 | Botimet e publikimeve | 700.00 | | | | | | | | | 60.00 | 700.00 | 60.00 |
| 14310 | Drekat zyrtare | | | | | | | | | 1,166.00 | | 1,166.00 | - |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | | | | | | | | | | 3,559.00 | - | 3,559.00 |
| | | 2,765.81 | 1,578.05 | 56,125.51 | 31,297.58 | 2,449.49 | 3,440.29 | 6,795.04 | 978.87 | 28,133.28 | 10,933.61 | 96,269.13 | 48,228.40 |
| | **Tabela A+B+C** | | | | | | | | | | | **212,949.96** | **108,807.55** |
| | **Krahasimi 2019/2018** | | | | | | | | | | | **-48.90** | |

## 3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike

| Kode | Përshkrimi | 2018 | 2019 | Diferenca | Krahasimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|
| 13130 | Shpenzimet e Udhetimit zyrtar brenda vendit | 5,764.60 | - | (5,764.60) | -100.00 |
| 13131 | Meditja e udhëtimit zyrtar brenda vendit | - | 1,080.00 | 1,080.00 | #DIV/0! |
| 13133 | Shpenzimet tjera te udhitimit zyrtar brenda vendit | - | 3,125.62 | 3,125.62 | #DIV/0! |
| 13140 | Shpenzimet e Udhetimit zyrtar jasht vendit | 495.60 | - | (495.60) | -100.00 |
| 13142 | Akomodimi gjate udhëtimit zyrtar jasht vendit | 120.00 | - | (120.00) | -100.00 |
| 13143 | Shpenzimet tjera te udhëtimit zyrtar jasht vendit | 35.20 | - | (35.20) | -100.00 |
| 13310 | Shpenzimet për internet | 224.06 | 374.41 | 150.35 | 67.10 |
| 13320 | Shpenzimet e telefonisë mobile | 3,618.25 | 403.68 | (3,214.57) | -88.84 |
| 13330 | Shpenzimet postare | 6,182.90 | 339.00 | (5,843.90) | -94.52 |
| 13420 | Shërbimet e përfaqësimit dhe avokatures | 519.08 | 435.76 | (83.32) | -16.05 |
| 13430 | Shërbime te ndryshme shendetësore | - | 60.00 | 60.00 | #DIV/0! |
| 13440 | Shërbime te ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse | 110.00 | 1,252.86 | 1,142.86 | 1,038.96 |
| 13450 | Shërbime shtypje- jo marketing | 1,021.14 | 759.00 | (262.14) | -25.67 |
| 13460 | Shërbime Kontraktuese Tjera | 7,615.50 | 18,174.00 | 10,558.50 | 138.64 |
| 13470 | Shërbime Teknike | 188.00 | - | (188.00) | -100.00 |
| 13480 | Shpenzimet për Antarësim | 3,815.60 | 2,810.40 | (1,005.20) | -26.34 |
| 13490 | Sherbimet e Varrimit | 8,457.70 | 9,900.00 | 1,442.30 | 17.05 |
| 13501 | Mobilje (me pak se 1000 euro) | 7,092.50 | - | (7,092.50) | -100.00 |
| 13506 | Pajisje speciale mjeksore (me pak se 1000 euro) | 1,572.75 | - | (1,572.75) | -100.00 |
| 13509 | Pajisje tjera (me pak se 1000 euro) | - | 70.00 | 70.00 | #DIV/0! |
| 13610 | Furnizime për zyrë | 11,676.45 | 1,506.10 | (10,170.35) | -87.10 |
| 13620 | Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare) | 3,371.65 | 3,416.63 | 44.98 | 1.33 |
| 13630 | Furnizime mjekësore | 1,490.37 | - | (1,490.37) | -100.00 |
| 13640 | Furnizime pastrimi | 677.50 | 166.55 | (510.95) | -75.42 |
| 13655 | Furnizim me preparate kimike | 252.00 | - | (252.00) | -100.00 |
| 13720 | Nafte per ngrohje qendrore | 29,794.40 | 11,443.87 | (18,350.53) | -61.59 |
| 13750 | Qymyr | 3,110.49 | - | (3,110.49) | -100.00 |
| 13760 | Dru | 6,804.61 | - | (6,804.61) | -100.00 |
| 13770 | Derivate per gjenerator | 177.58 | 151.38 | (26.20) | -14.75 |
| 13780 | Karburant per vetura | 13,831.93 | 11,326.58 | (2,505.35) | -18.11 |
| 13950 | Regjistrimi i automjeteve | 605.00 | 540.00 | (65.00) | -10.74 |
| 13951 | Sigurimi i automjeteve | 1,739.22 | 1,589.46 | (149.76) | -8.61 |
| 14010 | Mirembajtja dhe riparimi i automjeteve | 21,679.06 | 6,702.00 | (14,977.06) | -69.09 |
| 14020 | Mirembajtja e ndertesave | 15,910.68 | 2,126.35 | (13,784.33) | -86.64 |
| 14023 | Mirembajtja e shkollave | 482.95 | 75.00 | (407.95) | -84.47 |
| 14024 | Mirembajtja e objekteve shendetesore | 15,617.36 | - | (15,617.36) | -100.00 |
| 14030 | Mirembajtaj e auto rrugeve | - | - | - | #DIV/0! |
| 14032 | Mirembajtja e auto rrugeve lokale | 15,712.90 | 26,636.90 | 10,924.00 | 69.52 |
| 14040 | Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative | - | - | - | #DIV/0! |
| 14050 | Mirembajtja e mobileve dhe paisjeve | 1,596.00 | 95.00 | (1,501.00) | -94.05 |
| 14210 | Reklamat dhe konkurset | 1,600.00 | 50.00 | (1,550.00) | -96.88 |
| 14220 | Botimet e publikimeve | 2,700.00 | 60.00 | (2,640.00) | -97.78 |
| 14230 | Shpenzimet per informim publik | 1,758.24 | 500.00 | (1,258.24) | -71.56 |
| 14310 | Drekat zyrtare | 2,597.86 | 78.00 | (2,519.86) | -97.00 |
| 14320 | Drekat zyrtare jasht vendit | 23.00 | - | (23.00) | -100.00 |
| 14410 | Shpenzime-vendimet e gjykatave | 9,918.28 | 3,559.00 | (6,359.28) | -64.12 |
| 14420 | Pagesa-Neni 39.2 LMFPP | 2,989.55 | - | (2,989.55) | -100.00 |
| | **Totali** | **212,949.96** | **108,807.55** | **(104,142.41)** | **-48.90** |
| | | **(48.90)** | - | **48.90** | -100.00 |

Paraqitja grafike e raporti për Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike Janar-Shtator 2018/2019 dhe krahasimi i tyre në përqindje.




## 3.5 Shërbime Komunale

| Programet(Drejtoritë) | Rryma (13210) | | Uji (13220) | | Mbeturinat (13230) | | Telefon Internet 13250 | | Totali | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 | 2018 | 2019 |
| Shërbime Publike | 32,874.17 | 25,928.28 | 138.89 | 727.67 | 1,222.97 | 705.99 | | | 34,236.03 | 27,361.94 |
| Shëndetësia | 15,987.98 | 9,867.34 | 1,082.81 | 1,493.41 | 778.45 | 788.96 | | 242.73 | 17,849.24 | 12,392.44 |
| Qendra per pune Sociale | 324.17 | 413.48 | 57.79 | 47.47 | 42.08 | | | | 424.04 | 460.95 |
| Arsim dhe Shkencë | | 7,849.89 | | 1,422.02 | | 1,351.41 | | 188.89 | 0.00 | 10,812.21 |
| **Totali** | **49,186.32** | **44,058.99** | **1,279.49** | **3,690.57** | **2,043.50** | **2,846.36** | **0.00** | **431.62** | **52,509.31** | **51,027.54** |
| | **-10.42** | | **188.44** | | **39.29** | | | | **-2.82** | |

**Drejtori për Buxhet dhe Financa**

**Afrim Limani**

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), neni 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 10, paragrafi 10.2, dhe 10.5, shkronja (b), të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokat Bujqësore, nenit 6 paragrafi 6.3, neni 8, paragrafi 8.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, neni 2, neni 10 paragrafi 1 dhe 2, neni 39 dhe 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Vendimi të Qeveris së Republikës së Kosovës Nr. 03/52, datë 22.06.2018, për krijimin e zonës ekonomike, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2019 merr këtë:

**Draft- V E N D I M**
**Paraprak për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës me destinim kullosë e klasës së 6 në tokë ndërtimore për Zonën Ekonomike në fshatin Opterushë**

1. **Miratohet** Propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 01/130/19 i datës 10.04.2019 dhe merret vendimi paraprak për ndërrim destinim të përhershëm të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës P-71510056-20346-1.

2. Qëllimi i ndërrim destinimit të tokës me destinim kullosë e klasës së 6 është krijimi i zonës ekonomike.

3. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, toka me destinim kullosë, parcela kadastrale Nr. 00346-1, kullosë e klasës së gjashtë (6), në sipërfaqe pre 348984$^{m^2}$ (metër katrorë), apo tredhjet e katër hektar e tetëdhjetë e nëntë ari e tetëdhjetë e katër metra katrorë, e evidentuar në certifikatën mbi të drejtën e pronësisë së paluajtshme P-71510056-20346-1, zonë kadastrale Opterushë PSH E Kosovës KK. RAHOVEC, **destinohet tokë ndërtimore.**

4. Obligohet, Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm të kompletoj dokumentacioni dhe ta shfrytëzoj sipas pikës 2 të këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm , Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës

***U dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së***
- ***Arkivit.***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr-_______**
**Me datë_________**

**Afrim Dina**
________________
**Kryesues i Kuvendit**

# Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

*KomunaRahovec*

*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor**

Nr. protokolli 01/13 0/19
Me dt. 10.04.19
Rahovec

Në mbështetje të nenit 58, shkronja (h), lidhur me nenin 17 shkronja (a) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 10, paragrafi 10.2 dhe 10.5 shkronja (b), të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokat Bujqësore, nenit 6 paragrafi 6.3, neni 8, paragrafi 8.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, neni 74, paragrafi 2.9 dhe nenit 94 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Vendimi të Qeveris së Republikës së Kosovës Nr. 03/52, datë 22.06.2018, për krijimin e zonës ekonomike, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës në Rahovec i:

## PROPOZON

**Marrjen e vendimit paraprak për ndërrimin e destinimit të përhershëm të tokës kullosë eklasës së 6 në tokë ndërtimore për Zonën Ekonomike në fshatin Opterushë**

1. **Kryetari i Komunës** i propozon Komitetit për politikë dhe Financa dhe Kuvendit të komunës së Rahovecit të merret vendimi paraprak për ndërrim destinim të përhershëm të tokës me destinim kullosë e klasës së 6 në tokë ndërtimore të parcelës P-71510056-20346-1.

2. Qëllimi i ndërrim destinimit të tokës me destinim kullosë e klasës së 6 është krijimi i zonës ekonomike.

3. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, toka me destinim kullosë, parcela kadastrale Nr. 00346-1, kullosë e klasës së gjashtë (6), në sipërfaqe pre 348984$m^2$ (metër katrorë), apo 34 hektar e tetëdhjetë e nëntë ari e tetëdhjetë e katër metra katrorë, e evidentuar në certifikatën mbi të drejtën e pronësisë së paluajtshme P-71510056-20346-1, zonë kadastrale Opterushë PSH E Kosovës KK. RAHOVEC, **destinohet tokë ndërtimore.**

4. Obligohet, Drejtoria për Ekonomi Zhvillim dhe Turizëm të kopletoj dokumentacioni dhe ta shfrytëzoj sipas pikës 2 të këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm , Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm.

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës dhe 7 ditë pas shpalljes publike në uebfaqen e Komunës

*U dërgohet:*

- ***KPF-së,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**

## Arsyetim

Pas marrjes së vendimit Nr. 01/112, të datës 30.03.2004, nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit për krijimin e zonës ekonomike në fshatin Operushë, debatit publik me qytetarët e fshatit Opterushë dhe bizneset e Komunës së Rahovecit i mbajtur me datë:01.03.2019.
Vendimi mbi ndryshimin dhe plotësimin e vendimit mbi caktimin e zonës industriale 01 Nr.112 te datës:30.03.2004.
Vendimi për aprovimin e planit zhvillimor komunal të Rahovecit 01 Nr.2566 te datës:30.05.2013.
Vendimi i Qeversi së Kosovës Nr.03/53 te datës:22.06.2018 per krijimin e Zonës Ekonomike, ne fshatin Opterush komuna Rahovec.
Pëlqimi për rregullim të dokumetacionit teknik nga ana e KEDS Nr. 4/277 të datës 15.03.2019.
Si dhe pëlqimeve nga Ministrit përkatëse, për licencimin e Zonës Ekonomike ne Opterushë-Rahovec, dhe një ndër kriteret e Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë që parcela P-71510056-20346-1 të bëhet ndërrim destinim nga ana e kuvendit të komunës që të kopmpletohet dokumentacioni për licencimi i zonës Ekonomike.

-Te bashkangjitur keni edhe listën poseduese dhe
Kopjen eplanit

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510056-00346-1

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0015768/19 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 02.04.2019 - 09:32 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | OPTERUSHË / OPTERUŠA / OPTERUSHË |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>($m^2$) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510056-00346-1 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | Rural | 348984 | rfp. nr.8-2004,Rfp. nr.3-2018 | 20.06.2018 | 26.11.2018 |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| KAMENICA-ISPOD QESTE/KAMENICA-ISPOD QESTE/KAMENICA-ISPOD QESTE | | KAMENICA-ISPOD QESTE | 20.06.2018 | 26.11.2018 |

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person



Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Nazmi Krasniqi | P-71510056-00346-1 |

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosat/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 6/Pasnjak 6 Klase/6th Class Pasture | 348984 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC | KCID1502327 | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC / | | | 1/1 | Nr.pro.800-2018 | 26.11.2018 |

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

*Qeveria -Vlada-Government*

*Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning*

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

# KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Opterushë

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m2 |
|---|---|---|
| P-71510056-00346-1 | | |
| | | |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:5666

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 02.04.2019

Koha/ Vreme/ Time: 09:40:25

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (h), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neneve 2, 10 dhe nenit 40 paragrafi 2.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2019 merr këtë:

**D R A F T - V E N D I M**
**Marrjen e vendimit për caktimin e datës 7 dhjetor si Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" në Rahovec**

1. **Miratohet propozimi** i Kryetarit të Komunës Nr.01/127/19 i datës 05.04.2019 dhe merret vendim për caktimin e datës 7 (shtat) dhjetor si Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi".

2. Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, që në Ditën e bibliotekës për çdo vit, me 7 (shtatë) dhjetor të organizojë aktivitete kulturore, letrare, ekspozita dhe aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me krijimtari artistike.

3. Për çdo vit, në Ditën e Bibliotekës të ndahet çmimi letrar "Sulejman Krasniqi", për artin letrar dhe për krijimtari artistike.

4. Autorizohet Kryetari i Komunës që për çdo vit me vendim të veçantë të caktojë, komisionin që do të shqyrtojë dhe propozojë dhënien e Çmimit, duke u bazuar në kriteret, e veçanta profesionale dhe kontribute të shquara në fushat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***U dërgohet:***

- *,*
- ***DKRS-së***
- ***MAPL-së***
- ***Arkivi***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr-_______**
**Me datë__________**

**Afrim Dina**

__________________

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna Rahovec*
*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor**

Nr. protokolli 01/127/19
Me dt. 05.04.2019
Rahovec

Në bazë nenit 58 shkronja (h), 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (h), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neneve 2, 10 dhe nenit 40 paragrafi 2.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit:

**PROPOZON**
**Marrjen e vendimit për caktimin e datës 7 dhjetor si Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" në Rahovec**

1. Kryetari i Komunës së Rahovecit i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit caktimin e datës 7 dhjetor si Dita e Bibliotekës "Sulejman Krasniqi" në Rahovec.

2. Obligohet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, që në Ditën e Bibliotekës për çdo vit, më 7 dhjetor të organizojë aktivitete kulturore, letrare, ekspozita dhe aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me krijimtarinë artistike.

3. Për çdo vit në Ditën e Bibliotekës të ndahet çmimi letrar "Sulejman Krasniqi", për artin letrar dhe për krijimtari artistike.

4. Çmimi "Sulejman Krasniqi" ju ndahet krijuesve nga komuna e Rahovecit dhe një krijues mund ta fitojë këtë çmim më shumë se një herë.

Arsyetim

Sulejman Krasniqi i lindur më 7 dhjetor 1937 në Hoçë të Vogël të Rahovecit, ka qenë mësues, shkrimtar dhe atdhetar i devotshëm. Jeta dhe vepra e tij kanë domethënie të madhe për kulturën, historinë dhe trashëgiminë tonë kombëtare. Ka shkruar një mori veprash letrare dhe është i shquar për rezistencën e tij për liri e të drejta njerëzore e kombëtare. Prandaj, bazuar në këtë trashëgimi të pasur jetësore e krijuese, propozojmë që Kuvendi i Komunës së Rahovecit të marrë në shqyrtim propozimin për caktimin e datës së bibliotekës "Sulejman Krasniqi" dhe themelimin e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi".

***U dërgohet:***

- ***KPF-së,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**
**Kryetari i Komunës**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 dhe neni 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040,("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15, qershor 2008), dhe Nenit 10,39,40,46,57 dhe 94 paragrafit 1.3 dhe 3 të Statutit të Komunës së Rahovecit me 01.Nr.1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur me 30.04.2019 merr këtë:

**VENDIM**

1. **MIRATOHET** Propozimi i Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit: me Nr.98/19 i datës 10.04.2019 dhe merret vendimi që Kompanisë NTP„ Vëllezërit Morina'' SHPK për lëshimin e **Pëlqimi për 5 (pesë) vite** për shfrytëzimin e ngastrave kadastra le 777, 778 dhe 779 Fleta poseduese Nr. 478, në vendin e quajtur Rakita vija - rakita zona kadastrale Xërxe , për prodhimin e betonit dhe seperacionit të rërës.

2. Me qëllim të evitimit të pengesave juridike , zhvillimit të rregullte të procedurës për licencimin pranë institucioneve të Kosovës ( KPMM , MMPH, MBPZHR) e konsiderojmë si të arsyeshëm që ky propozim të aprovohet nga Kuvendi i Komunës.

3. Ngastrat kadastrale në të cilët NTP„ Vëllezërit Morina '' SHPK do të aplikoj në institucionet e Republikës së Kosovës për licencim është pronë private e z. Fadil Morina respektivisht pronarit të vetë ngastrës kadastrale **dhe është zonë e mbrojtur e përcaktuar me Vendimin 01Nr. 352/13 të datës 09.04.1986 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit .**

4. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive që kur do herë sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të revokoj Pëlqimin apo të ndryshoj vendimin.

5. Obligohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Inspektim të kujdesen për implementimin e këtij Vendimit komfor rregullat ivës në fuqi .

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit ky Vendim hynë në fuqi7 ditë pas shpalljes publike dhe në ueb faqen zyrtare të Komunës.

*U dërgohet :*
*1. MAPL-së dhe*
2.*Arkivit*

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01.Nr.**
**Rahovec, ______ 2019**

**Afrim Dina**

______________
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

---

Nr. protokollit 38
Me datë: 10.04.19
Rahovec

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040,("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15,qershor 2008), nenit 74 paragrafi 2.9 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017 dhe në bazë të kërkesës kompanisë NTP „Vëllezërit Morina'' me 12Nr. 61 të datës 20.03.2019, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit:

**P R O P O Z O N**

1. Kuvendit të Komunës së Rahovecit të miratoj kërkesën e kompanisë NTP„ Vëllezërit Morina'' SHPK dhe ti lëshohet **Pëlqimi për 5 ( pesë )vite** për shfrytëzimin e ngastrave kadastrale 777, 778 dhe 779 Fleta poseduese Nr.478, në vendin e quajtur Rakita vija - rakita zona kadstrale Xërxe , për prodhimin e betonit dhe seperacionit të rërës .

2. Me qëllim të evitimit të pengesave juridike, zhvillimit të rregullte të procedurës për licencimin pranë institucioneve të Kosovës ( KPMM, MMPH, MBPZHR) e konsiderojmë si të arsyeshëm që ky propozim të aprovohet nga organi i lartë cekur .

3. Ngastrat kadastrale në të cilët NTP „Vëllezërit Morina''SHPK do të aplikoj në institucionet e Republikës së Kosovës për licencim janë pronë private e z.Fadil Morina respektivisht pronarit të vetë ngastrës kadastra le dhe është zonë e mbrojtur e përcaktuar me 01Nr. 352/13 të datës 09.04.1986 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

4. Komuna e Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive që kur do herë sipas nevojës, për realizimin e interesave publike të Komunës të revokoj Pëlqimin apo të ndryshoj vendimin ku lidhur me inicimin e procedurës parashtruesit i kërkesës do të njoftohet 6 muaj përpara.

5. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës të autorizohet Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Inspektim të kujdesen për implementimin e këtij Vendimit komfor rregullativës në fuqi .

6. Ky propozim hyn në fuqi pas miratimit paraprak nga Kuvendi i Komunës.

***Të njoftohen:***

- ***Kryesuesi dhe anëtarët e Kuvendit***
- ***Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit***
- ***Sekretaria e Kuvendit dhe***
- ***Arkivi.***

REPUBLIKA E KOSOVËS Komuna e Rahovecit Drejt. për Urb.Planif.dhe Mbr.Mjed. RAHOVEC XII ORAHOVAC Opština Orahovac Odelj. za Urban.Planir.i Zašt.Sred. REPUBLIKA KOSOVA

**Rumir Zhuniqi**

**Drejtor i DUPMM**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*

**MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING**
**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY**

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : MORINA FADIL

| | |
|---|---|
| **Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:** | **08-942/03-0013901/19** |
| **Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:** | 20.03.2019 - 15:39 |
| **Komuna / Opština / Municipality:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| **Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:** | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name | Emri Ime First Name | Emri i babait Ime oca Father's Name | Gjinia Pol Gender | Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No. | Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili uknjiženja Country ofcitizenship | Ditëlindja/Data e themelimit Rodendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| MORINA | FADIL | GANI | Mashkull / Musko / Male | **1002859471** | KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO | | | 28.09.2015 |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Adresa tjetër Druga adresa Other address | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| GJAKOVË- J.QYTET / ĐAKOVICA- I.GRADA / GJAKOVE-J. QYTET | | | GJAKOVË | 28.09.2015 |

## B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

| Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit | Komuna / Opština / Municipality | Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone | Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type | Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind | Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number | Vendi i quajtur Zvano mesto Place name | Sipërfaqja Površina Area | Shfrytezimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **P-71510033-00776-5** | Rahovec / Orahovac / Rahovec | XËRXË / ZRZE / XËRXË | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | RAKITA VIJA-RAKITA / RAKITA VIJA-RAKITA / RAKITA VIJA-RAKITA | **1540** | Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 4 / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 4 Klase / / Agriculture - Arable - 4th Class Arable Land / / | **1 / 1** | Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | 12.03.2019 |
| **P-71510033-00777-0** | Rahovec / Orahovac / Rahovec | XËRXË / ZRZE / XËRXË | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | RAKITA VIJA-RAKITA / RAKITA VIJA-RAKITA / RAKITA VIJA-RAKITA | **1383** | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 3 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 3 Klase / / Agriculture - pasture - 3rd Class Pasture / / | **1 / 2** | Bashkë Posedim / SuDrzavina / co-possessor | 28.09.2015 |
| **P-71510033-00778-0** | Rahovec / Orahovac / Rahovec | XËRXË / ZRZE / XËRXË | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | RAKITA VIJA-RAKITA / RAKITA VIJA-RAKITA / RAKITA VIJA-RAKITA | **6074** | Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 4 / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 4 Klase / / Agriculture - Arable - 4th Class Arable Land / / | **1 / 2** | Bashkë Posedim / SuDrzavina / co-possessor | 28.09.2015 |
| **P-71510033-00779-2** | Rahovec / Orahovac / Rahovec | XËRXË / ZRZE / XËRXË | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | RAKITA VIJA-RAKITA / RAKITA VIJA-RAKITA / RAKITA VIJA-RAKITA | **924** | Bujqësore - Arat - Arë E Klasës 4 / / Poljoprivredno - Njive - Njiva 4 Klase / / Agriculture - Arable - 4th Class Arable Land / / | **1 / 2** | Bashkë Posedim / SuDrzavina / co-possessor | 28.09.2015 |
| **P-71510033-00780-0** | Rahovec / Orahovac / Rahovec | XËRXË / ZRZE / XËRXË | **PARCELË / PARCELA / parcel** | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | GRADISH- / GRADISH- / GRADISH- | **519** | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 4 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 4 Klase / / Agriculture - pasture - 4th Class Pasture / / | **1 / 2** | Bashkë Posedim / SuDrzavina / co-possessor | 28.09.2015 |

KUVENDIT KOMUNAL NË RAHOVEC
-DREJTORISË PËR URBANIZËM PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT –

**Lënda**: Kërkesë për dhënjen e pëlqimit, për prodhimin e betonit dhe seperacionit të rërës.

NTP "Vëllëzërit Morina" SHPK me seli në Xërëxë i drejtohemi me këtë kërkesë Kuvendit Komunal – Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, që të na **aprovoj** kërkesën tonë për dhënëjen e pëlqimit, për prodhimin e betonit dhe seperacionit, për shfrytëzimin e ngastarave kadastrale 777,778 dhe 779 nga Fleta poseduese 478 ZK Xërxë, në vendin e quajtur "Rakita vija – rakita".

Drejtorisë të cekur më lartë i propozojmë që të na lëshojë pëlqimin deri sa ne të paisemi me dokumentacionin përcjellës pranë KPMM, MMPH dhe MBPZHR.

Kuvendit Komunal - Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, i propozoj që mundësisht këtë kërkesë ta shqyrtoj **sa ma shpejtë – në mënyrë urgjente,** për shkak se pa dhënjën e këtij pëlqimi ne nuk mund të punojmë, sepse neve na është bllokuar puna deri në marrjen e pëlqimit

a n d a j

Mbesim me shpresa se kjo kërkesë e jonja do të **A P R O V O H E T** dhe të na ipet pëlqimi, për prodhimin e betonit dhe seperacionit të rërës.

Rahovec,
20.03.2019

Kërkesën e parashtroi:
F. Morina
Fadil Morina
Drejtor NTP" Vëllëzërit Morina" SHPK

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova - Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-
Ministry of Trade and Industry

Agjensioni i Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë / Kosovska Agencija za Registracije Biznisa /
Kosova Business Registration Agency

# CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT
# CERTIFIKAT O REGISTRACIJI
# CERTIFICATE OF REGISTRATION

**70366136**

(Nr. i biznesit / Br. biznisa / Business No.)

**N.P.T. „Vëllezërit Morina" Sh.p.k.**

Emri i biznesit / Naziv biznisa / Name of Business

| | |
|---|---|
| **Lloji i biznesit**<br>**BusinessType**<br>**Tip biznesa** | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara<br>Limited liability company<br>Društvo sa ograničenom odgovornošću |
| **Adresa**<br>**Address**<br>**Adresa** | Republika e Kosovës,Rahovec,Xërxë<br>Republic of Kosovo,Orahovac,Xërxë<br>Republika Kosova,Orahovac,Xerxe |
| **Data e inkorporimit**<br>**Date of Incorporation**<br>**Datum inkorporiranja** | 21/06/2006 |
| **Data e regjistrimit**<br>**Date of registration**<br>**Datum registracije** | 23/06/2006 |

09/07/2010

Data/Date/Datum

Nenshkrimi/Signature/Potpis

# Informata mbi biznesin
# Information about business
# Informacija o biznisu

**Nr. Biznesit/Business No./Br. Biznisa**
70366136

## Aplikacioni/Application/Aplikacija

| | |
|---|---|
| **Subjekti i regjistrimit:**<br>**Registration subject**<br>**Subjekt registracije:** | |
| **Data e plotësimit:**<br>**Filling date:**<br>**Datum:** | 23/06/2006 |
| **Date e pranimit:**<br>**Reception date:**<br>**Datum primljenje** | |
| **Numri i protokolit:**<br>**Protocol number:**<br>**Broj protokola:** | 116003003 |

## Biznesi/Business/Biznis

| | |
|---|---|
| **Tipi i biznesit:**<br>**Business type:**<br>**Tip biznisa:** | Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara<br>Limited liability company<br>Društvo sa ograničenom odgovornošću |
| **Emri i biznesit:**<br>**Business name:**<br>**Naziv biznisa:** | N.P.T.,,Vëllezërit Morina" Sh.p.k. |
| **Adresa:**<br>**Address:**<br>**Adresa** | Republika e Kosovës,Rahovec,Xërxë<br>Republic of Kosovo,Orahovac,Xërxë<br>Republika Kosova,Orahovac,Xerxe<br>, |
| **Data e konstituimit:**<br>**Constitution date:**<br>**Datum konstituisanja:** | 21/06/2006 |
| **Kapitali i përgjithshëm:**<br>**Total Capital:**<br>**Totalni kapital:** | € 20,000.00 |
| **Numri i puntorëve:**<br>**Number of employees:**<br>**Broj radnika:** | 3 |

# Informata mbi biznesin
# Inforamtion about business
# Informacija o biznisu

**Nr. biznesit/BusinessNo./Br.Biznisa**

70366136

**Shenim me rëndësi/Importnat Note/Vazan podatak**

Biznesi Ndermarrja Prodhuese Transportuese "Vellezrit Morina" është themeluar si Biznes Individual me daten 30.05.2000 me numër të biznesit 80102232.

Me daten 21.06.2006 ky biznes shëndrrohet në Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar me emer te biznesit "Vellezrit Morina" SH.P.K. dhe merr numer të ri të biznesit 70366136.

**Informata plotësuese/Additional Information/Dodatna informacija**

Ndërrim Pronari,Drejtori,Agjenti i Regjistruar

70366136

## Veprimtaritë/Activities/Delatnosti

| | | |
|---|---|---|
| **0812** | | |
| | Primar | Nxjerrja e zhavorrit dhe rërës, nxjerrja e argjilës dhe kaolinit<br>Operation of gravel and sand pits; mining of clays and kaolin<br>Delatnosti šljunčara i pješčara; vađenje gline i kaolina |
| **2363** | | |
| | Sekondar | Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim<br>Manufacture of ready-mixed concrete<br>Proizvodnja žbuke |
| **2369** | | |
| | Te Tjera | Prodhimi i artikujve të tjerë prej betonit, llaçit dhe çimentos<br>Manufacture of other articles of concrete, plaster and cement<br>Proizvodnja ostalih proizvoda od betona, cementa i gipsa |
| **4941** | | |
| | Te Tjera | Transporti rrugor i mallrave<br>Freight transport by road<br>Drumski prevoz robe |
| **8292** | | |
| | Te Tjera | Aktivitetet e paketimit (ambalazhimit)<br>Packaging activities<br>Delatnosti pakiranja |
| **9609** | | |
| | Te Tjera | Aktivitetet e tjera p.k.t.<br>Other personal service activities n.e.c.<br>Ostale licne uslužne delatnosti, d. n. |

70366136

## Bordi i drejtorëve/Board of directors/Bord Direktora

| | |
|---|---|
| **Emri:** **Name:** **Ime:** | Lulzim Morina |
| **ID Personale:** **Personal ID:** **Licni ID:** | 1030205177 |
| **Pozita e punës:** **Job position:** **Radno mesto:** | Drejtor |
| **Adresa:** **Address:** **Adresa:** | Republika e Kosovës,Gjakovë,Gjakovë<br>Republic of Kosovo,Djakovica,Djakovica<br>Republika Kosova,Djakovica,Djakovica<br><br>Esat Stavileci p.n. |

70366136

**Pronarët/Owners/Vlasnici**

Person fizik

**Emri:**
**Name:** Lulzim
**Ime:** Morina

**ID Personale:**
**Personal ID:** 1030205177
**Licni ID:**

**Adresa:** Republika e Kosovës,Gjakovë,Gjakovë
**Address:** Republic of Kosovo,Djakovica,Djakovica
**Adresa:** Republika Kosova,Djakovica,Djakovica
Esat Stavileci p.n.

**Përgjegjësia:**
**Liability:**
**Odgovornost:** Përgjegjësi e kufizuar

**Pjesa në pronë:**
**Owned part:**
**Deo o vlasnistvu:**

**Pjesa e paguar:**
**Paid Part:**
**Placeni deo:**

**Data e lindjes:**
**Date of birth:** 1968.08.23
**Dan rodjenja:**

---

Person fizik

**Emri:**
**Name:** Fadil
**Ime:** Morina

**ID Personale:**
**Personal ID:** 1002859471
**Licni ID:**

**Adresa:** Republika e Kosovës,Gjakovë,Gjakovë
**Address:** Republic of Kosovo,Djakovica,Djakovica
**Adresa:** Republika Kosova,Djakovica,Djakovica
Esat Stavileci p.n.

**Përgjegjësia:**
**Liability:**
**Odgovornost:** Përgjegjësi e kufizuar

**Pjesa në pronë:**
**Owned part:**
**Deo o vlasnistvu:**

**Pjesa e paguar:**
**Paid Part:**
**Placeni deo:**

**Data e lindjes:**
**Date of birth:** 1965.07.07
**Dan rodjenja:**

---

70366136

## Personat e autorizuar/Authorized participants/Ovlascene lice

| | |
|---|---|
| **Emri:**<br>**Name:**<br>**Ime:** | Fadil<br>Morina |
| **ID Personale:**<br>**Personal ID:**<br>**Licni ID:** | 1002859471 |
| **Pozita e punës:**<br>**Job position:**<br>**Radno mesto:** | Agjent i Regjistruar |
| **Adresa:**<br>**Address:**<br>**Adresa:** | Republika e Kosovës,Rahovec,Xërxë<br>Republic of Kosovo,Orahovac,Xërxë<br>Republika Kosova,Orahovac,Xerxe<br>/ |

# 1.0 PJESA E PERGJITHSHME

## 1.1 HYRJE

Në bazë të kërkesës së kompanisë N.N.SH. "VËLLZRIT MORINA BETON" Xwrxe KK. Rahovec ,drejtuar N.P.SH."CONSULTING " LYPJAN merr për sipër punimin e Elaboratit gjeologjik, studimin e karakteristikave cilësore të inerteve dhe llogaritjen e rezervave të vendburimit të zhavorrit dhe rërës në ngastrën 930.

Pas kryerjes rekongonisimit të terrenit në lokacionin e dhënë është vërtetuar se materialet ndërtimore , si rëra dhe zhavorri paraqesin lëndë të mirë dhe rezerva të konsiderueshme për industrinë ndertimore .

Punimi dhe studimi përfshin temat e domosdoshme për një elaborate:

- *të dhënat e përgjithshme për vendburim*
- *karakteristikat cilësore të lendes së parë*
- *Hidrogjeologjia e vendburimit*
- *llogaritja e rezervave*
- *vlerësimi I vendburimit*

Pjesa tekstuale i bashkëngjitet materiali dokumentues dhe shtojcat grafike.

## 1.2 POZITA GJEOGRAFIKE E VENDBURIMIT

Vendburimi "Rakita "i inerteve aluviale që gjendet në fshatin Xwrxe, ku pwr mes fshatit kalon rruga rajonale Gajkov - Xërxe-Rahovec. Fshati Xwrxe ndodhet në një distancë nga qendra komunale e Rahovecit 11km. Lokaliteti i quajtur" Rekita" në fshatin Xwrxe ndodhet në distancë 0.6km në përendim nga rruga rajonale Gjakovw - Prizren. Në aspektin rajonal i takon rrafshit të Dukagjinit .Ky lokalitet shtrihet në anën e majtë të rrjedhjes së lumi Drini i Bardh si dhe në anën perëndimore kufizohet me fshatin Rogov dhe në anen jugore me Hoq dhe nw veri me Gradish.

Në aspektin administrative vendburimi shtrihet në komunën katastrale të Xwrxes në ngastren 930.

Vendburimi ka një pozitë të përshtatshme gjeografike në aspektin e lidhjeve me rrjetin e rrugëve. Pozita gjeografike është dhënë në hartën gjeografike 1:500000

## 1.3 POZITA HAPSINORE E VENDBURIMIT(Ngastrës)

Ngastrat me Nr. 930 i takon komunës Kadasatrale të Xwrxes- KK.së Rahovec . Kjo ngastër shtrihet në anen e majtë dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të rrjedhës së Drinit të Bardh .Kanë një sipërfaqe për shfrytëzim 00.71.18 ha.

Forma vendburimit si dhe koordinatat e pikave të tyre të skajshme janë dhënë në shtojcën në vazhdim:

| Pika | Y | X |
|---|---|---|
| 1 | 7463625.01 | 4690219.82 |
| 2 | 463635.20 | 690255.90 |
| 3 | 4633637.42 | 690263.22 |
| 4 | 463601.92 | 690273.62 |
| 5 | 463565.05 | 690284.11 |
| 6 | 463517.47 | 690297.79 |
| 7 | 463482.25 | 690307.75 |
| 8 | 463482.08 | 690291.16 |
| 9 | 463481.91 | 690261.73 |
| 10 | 463533.63 | 690259.69 |
| 11 | 463531.66 | 690238.18 |

## 1.4 KARAKTERISTIKAT GJEOGRAFIKE-EKONOMIKE TË RAJONIT

Rrafshi i Dukagjinit paraqet një fushë gropë me një shtrirje të madhe në pjesën veriperëndimore të Kosoves. Relevi i këtij rrafshi është i sheshtë me ngritje relevore të ulët me shpate të buta dhe ramje në drejtim të juglindjes gjegjsishtë në drejtm të rrjedhjes së Drinit të Bardhë.

Degët e Drinit të Bardhë kanë formuar lugina jo të thella afër 150m me shtretër relativisht të ngushtë me zaje, zhavorre,rëra e blloqe shkëmbore. Luginat kanë dysheme të rrafshëta dhe terca lumore të gjëra.

Sedimentet liqenore në fundin e luginave dhe tarracave të vjetra janë të mbuluara me sedimentet lumore më të reja dhe shumë pjellore në aspektin agrar..Në vende të rrafshëta është zhvilluar aluviumi ,proliviumi, ndërsa në shpatet malore janë zhvilluar depozitimet diluviale.

Rajoni ka kushte dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillim ekonomik

KUVENDIT KOMUNAL NË RAHOVEC
-DREJTORISË PËR URBANIZËM PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT –

**Lënda**: Kërkesë për dhënjen e pëlqimit, për prodhimin e betonit dhe seperacionit të rërës.

NTP "Vëllëzërit Morina" SHPK me seli në Xërëxë i drejtohemi me këtë kërkesë Kuvendit Komunal – Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, që të na **aprovoj** kërkesën tonë për dhënëjen e pëlqimit, për prodhimin e betonit dhe seperacionit, për shfrytëzimin e ngastarave kadastrale 777,778 dhe 779 nga Fleta poseduese 478 ZK Xërxë, në vendin e quajtur "Rakita vija – rakita".

Drejtorisë të cekur më lartë i propozojmë që të na lëshojë pëlqimin deri sa ne të paisemi me dokumentacionin përcjellës pranë KPMM, MMPH dhe MBPZHR.

Kuvendit Komunal - Drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, i propozoj që mundësisht këtë kërkesë ta shqyrtoj **sa ma shpejtë – në mënyrë urgjente,** për shkak se pa dhënjën e këtij pëlqimi ne nuk mund të punojmë, sepse neve na është bllokuar puna deri në marrjen e pëlqimit

a n d a j

Mbesim me shpresa se kjo kërkesë e jonja do të **A P R O V O H E T** dhe të na ipet pëlqimi, për prodhimin e betonit dhe seperacionit të rërës.

Rahovec,
20.03.2019

Kërkesën e parashtroi:
F. Morina
Fadil Morina
Drejtor NTP" Vëllëzërit Morina" SHPK

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

Në bazë të nenit 12.2 shkronja (d), neni 17 shkronja (k) nenit 29, neni 40.2 shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), Nenit 10 paragrafi 2.4 neni 40 paragrafi 2.3 dhe neni 46 paragrafi 1, i Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2019, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për miratimin e marrëveshjes për bashkëfinancim dhe themelimin e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për ndarje të shtëpive për banim**

**1.** Miratohet marrëveshja për bashkëfinancim Nr. 355/19, dt. 08.04.2019 e lidhur në mes të Komunës së Rahovecit dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", për ndërtimin e 7 (shtatë) shtëpive për banim, për familjet në gjendje të rëndë ekonomike e sociale të cilët nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit, prej të cilave, për 7 (shtatë) shtëpi do të participoj Komuna e Rahovecit me nga 5.000.00€ ( Pesë mijë euro), për çdo shtëpi të ndërtuar nga Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", me seli në Prizren..

**2.** Pagesa e mjeteve financiare të cekur në pikën 1 (një) të këtij vendimi, do të bëhet nga buxheti i Komunës së Rahovecit nga kodi i investimeve kapitale 48145 "Ndërtimi i shtëpive dhe material ndërtimor për familjet në nevojë"

**3.** Lidhur me këtë çështje themelohet komisioni për shqyrtim të kërkesave për ndarje të shtëpive për banim, në këtë përbërje:

**3.1** _________________, kryesues i Komisionit
**3.2** _________________, anëtar nga kuvendi
**3.3** _________________, anëtar nga ekzekutivi
**3.4** _________________, anëtar/e nga shoqëria civile,
**3.5** Berat Kabashi, nga Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit",

**4.** Komisioni i cekur në pikën 3 të këtij vendimi do të bëjë pranimin e kërkesave të qytetarëve të Komunës së Rahovecit dhe shqyrtimin e tyre, ndërsa pas propozimit nga ana e komisionit, vendimin përfundimtar për përfitim të donacionit për ndërtimin e shtëpive do ta merr Kryetari i Komunës.

**5.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për ndarje të shtëpive për banim.

**6.** Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***U dërgohet:***

- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së***
- ***Arkivi***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr-**_______
**Me datë**__________

**Afrim Dina**

_______________

**Kryesues i Kuvendit**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. I prot / Br. prot. 355 Më / Dt. 08.04.2019
RAHOVEC - ORAHOVAC

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

Shoqata Bamirëse
Jetimat e Ballkanit

**MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËFINACIM**

**E hartuar me datën 8 prill, 2019, e lidhur në mes të palëve:**

1. **Komunës së Rahovecit,** përfaqësuar nga Smajl Latifi, Kryetar i Komunës në Rahovec dhe

2. Shoqata Bamirëse **"Jetimat e Ballkanit",** Rruga "Bekim Muhaxheri" Nr. 18, me Seli në Prizren të cilën e përfaqëson z. Berat Kabashi, drejtor i Shoqatës.

**Neni 1.**
**Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi të kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit me bashkëfinancim, në mes të Shoqatës Bamirëse **"Jetimat e Ballkanit"** në njërën anë dhe **Komunës së Rahovecit** në anën tjetër, është sigurimi i mjeteve financiare për financim të përbashkët të ndërtimit të shtatë (7) shtëpive për banim, për familjet në gjendje të rëndë ekonomike e sociale të cilët nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.

**Neni 2.**
**Obligimet e palëve**

**2.1 Komuna e Rahovecit,** merr përsipër të bashkëfinancojë me mjete financiare në vlerë prej 5,000.00€ ( pesë mijë euro), për secilën shtëpi që ndërtohet nga Shoqata Bamirëse **"Jetimat e Ballkanit"**
**2.2 Pagesa do të bëhet**, nga buxheti i Komunës së Rahovecit përkatësisht nga kodi buxhetor "Ndërtimi i shtëpive dhe material ndërtimor për familjet në nevojë".
**2.3** Mjetet për financimin e shtëpive do të transferohen në llogarinë bankare Nr. XK051110318280000140 në Pro Credit Bank të Shoqatës Bamirëse **"Jetimat e Ballkanit".**

**Neni 3.**
**Obligimet e Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit"**

**3.1. Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit"** me seli në Prizren, merr përsipër ndarjen e mjeteve të tjera financiare të nevojshme për bashkëfinancim të finalizimit, të ndërtimit të 7 (shtatë) shtëpive për banim, për familjet në gjendje të rëndë ekonomike e sociale të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit.
**3.2. Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit"** dhe Komuna e Rahovecit, pajtohen që përzgjedhja e familjeve që do t'ju ndërtohet shtëpia, të bëhet përmes caktimit të një

komisioni të përbashkët i përbërë nga përfaqësuesit e Komunës së Rahovecit dhe përfaqësuesit e Shoqatës Bamirëse **"Jetimat e Ballkanit"**.

**3.3**. Shoqata Bamirëse **"Jetimat e Ballkanit"** do të dorëzojë pa vonesë në Komunën e Rahovecit një raport për çdo shtëpi të ndërtuar.

**3.4** Komuna e Rahovecit do të caktojë një komision profesional në cilësinë e organit mbikëqyrës për përcjelljen dhe realizimin e kësaj marrëveshjeje.

**Neni 4.**
**Zgjidhja e marrëveshjes**

Të gjitha palët zotohen se do t`i përmbahen kësaj marrëveshjeje të mirëkuptimit për bashkëfinancim dhe se në rast kontesti eventual apo paqartësitë në tekstin e kësaj marrëveshjeje, të zgjidhen me anë të bisedimeve, konsultimeve miqësore dhe me mirëkuptim, në të kundërtën kompetent për të vendosur do të jetë Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike.

**Neni 5.**
**Hyrja në fuqi**

**5.1** Marrëveshja e mirëkuptimit me bashkëfinancim në mes të Komunës së Rahovecit dhe Shoqatës Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit.

**5.2** Kjo marrëveshje bashkëfinancim është e hartuar në 4, ekzemplarë identik ku nga një e marrin palët, kurse të tjerat mbesin për nevojat e organit kompetent.

**P a l ë t n ë m a r r ë v e sh j e**

| | |
|---|---|
| **z. Berat Kabashi** | **Smajl Latifi** |
| ______________ | ______________ |
| **"Jetimët e Ballkanit"** | **Kryetar i Komunës** |

**Rahovec, 8 prill, 2019**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

Në mbështetje të nenit 12, nenit 17, dhe nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neneve, 2, 10, 39, 46, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1.19 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2019 merr këtë:

**DRAFT - V E N D I M**
**Për miratimin e planit të veprimit për transparencë 2019-2023**

1. **Miratohet,** plani i veprimit për transparencë për katër vite 2019-2023.

2. Shtojcë e këtij vendimi është Plani i Veprimit për transparencë 2019-2023.

3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës,

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL-në, dhe pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

***U dërgohet:***
- ***Kuvendit ,***
- ***MAPL-së***
- ***Arkiv***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr-_______**
**Me datë__________**

**Afrim Dina**
________________
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

**Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec**

**Kryetari i Komunës /Presednik Opštine/ Municipal Mayor**

---

# **DRAFT** P L A N I KOMUNAL

# I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË **PËR KATËR VITE**

( 2019-2023)

**..... 2019**

**Në bazë të nenit 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040,("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dhe nenit 92 paragrafi 1, nenit 17, 18 19, 20, 21 dhe 22 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017 dhe nenit 15 pika 1 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 04/2018 për Transparencë në Komuna dhe legjislacionin tjetër që janë në fuqi.**

**DRAFT** P L A N I KOMUNAL

I VEPRIMIT PËR TRANSPARENCË **PËR KATËR VITE**

(2019-2023)

Hapat konkretë, që Kuvendi i Komunës së Rahovecit do të ndërmarrë në funksion të përmbushjes së Planit të Veprimit dhe rekomandimeve të ekzekutivit të Komunës përfshijnë objektivat si në vijim:

1. **Objektivi i parë i përcaktuar në këtë plan ka të bëjë me mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe të Komiteteve tjera. Në këtë objektiv parashikohet:**

   **1.1** Njoftim për mbledhjet e rregullta të Kuvendit të Komunës dhe komiteteve përmes faqes zyrtare, rrjetet sociale në medie të shkruara dhe elektronike, mbi vendin e mbajtjes së mbledhjes me agjendë.

   **1.2** Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe njoftohet Zyra e Informimit për të publikuar njoftimin, së paku shtatë ( 7) ditë pune përpara mbajtjes së mbledhjes.

   **1.3** Mbledhjet e Kuvendit do të përcillen online përmes faqes zyrtare të Komunës dhe teleprezencës për monitorim nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe kanalit të YouTube.

   **1.4** Kryesuesi i Kuvendit njofton Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal shtatë (7) ditë pune para mbledhjes së rregullt të Kuvendit.

2. **Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.**

   **2.1** Njoftim për mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës përmes web-faqes zyrtare në medie të shkruara/elektronike, rrjetet sociale mbi vendin e mbajtjes së mbledhjes me agjendë.

   **2.2.** Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe njoftohet Zyra e Informimit për të publikuar njoftimin së paku tre (3) ditë para mbajtjes së mbledhjes.

   **2.3** Mbledhjet e jashtëzakonshme do të përcillen online përmes faqes zyrtare të Komunës dhe teleprezencës për monitorin nga Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe kanalit të YouTube.

   **2.4** Kryesuesi i Kuvendit njofton Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal tre (3) ditë pune para mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit.

   **2.5** Procedurat e lartëpërmendura nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.

3. **Konsultimi me publikun, ku parashikohet të këtë:**

   **3.1** konsultimi për buxhet,

   **3.2** konsultimi për zhvillim ekonomik lokal,

3.3. konsultimi për planifikim hapësinor,

3.4. konsultimi për investime,

3.5. konsultimi për të hyra komunale dhe

3.6. konsultimi për çështje tjera në interes të përgjithshëm.

3.7. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga sekretaria e Kuvendit dhe njoftohet Zyra e Informimit së paku dy (2) javë para mbajtjes së konsultave me publikun dhe publikohet në web-faqe zyrtare të komunës, në media të shkruara dhe elektronike, në rrjete sociale si dhe në vendet e frekuentuara.

**4. Takimet me publikun, ku parashikohet:**

4.1. Komuna, përkatësisht Kryetari i Komunës, do të mbajë së paku dy (2) takime me publikun me qytetarë gjatë vitit (njëri në fund të gjashtëmujorit të parë dhe tjetri në fund të vitit fiskal), për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilin takim mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë.

4.2. Përveç këtyre dy takimeve publike me qytetarë, Komuna mund të mbajë edhe takime tjera me publikun që do të shqyrtohen objektivat e parapara në pikën tre (3) të këtij Plan Veprimi.

4.3. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga kabineti i Zyrës së Kryetarit, përkatësisht nga Zyra e Informimit, së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit me publikun dhe publikohet në web-faqe zyrtare të Komunës, në media, vende të frekuentuara si dhe në rrjetin social.

**5. Takimet e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ, dhe gazetarë.**

5.1. takime në formë debati me qytetarë,

5.2. takime pyetje dhe përgjigje,

5.3. konferenca për media,

5.4. Kryetari i Komunës cakton një ditë brenda javës që në Zyrën e Kryetarit të ketë takime me qytetarë.

5.5. Njoftimit bëhet nga shefi i kabinetit të kryetarit, përmes Zyrës së Informimit, për njoftimin e agjendës dhe vendin e mbajtjes së takimeve.

**6. E drejta e qasjes në dokumente publike.**

6.1. Kërkesa për qasje në dokumente trajtohet nga secili organ i Komunës që posedon dokumentin duke mbikëqyr informatën,

6.2. Organi komunal ndihmon kërkuesin për qasje në dokumente publike aq sa është e mundshme për të identifikuar dokumentin e kërkuar dhe trajtimi bëhet në mënyrë të barabartë.

6.3. Aktiviteti i njoftimit bëhet nga zyrtari i caktuar nga Organi brenda (7) ditësh dhe mund të vazhdohet deri në 15 ditë.

6.4 Njësia/zyra për Informim bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike dhe i adreson ato tek njësia ku gjendet dokumenti/informata, dhe pas

marrjes së dokumenteve/informatës, në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike e dërgon të kërkuesi.

**6.5** Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike dhe fillimisht i adresohet zyrtarit për shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, pastaj zyrtari në fjalë e përcjell tek organi/njësia ku është dokumenti.

**7. Shqyrtimi i kërkesave për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet.**

**7.1.** Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të trajtohen drejtpërdrejtë apo përmes kërkesave me shkrim.

**7.2.** Kërkesat për informim, nismat qytetare dhe peticionet do të shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës, brenda afatit prej 60 ditësh.

**7.3.** Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit dhe i përcjellët Zyrës së Informimit për publikimin e njoftimit.

**8. Publikimin e akteve komunale.**

**8.1.** Të gjitha Rregulloret, Vendimet dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilit nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhet publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL.

**8.2.** Të gjitha këto akte nënligjore dhe dokumentet tjera publikohen në web faqen zyrtare të Komunës, pas pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas regjistrimit në MAPL, ndërsa dokumentet tjera pas hyrjes në fuqi.

**8.3** Aktiviteti i njoftimit bëhet nga Sekretaria e Kuvendit, ndërsa publikimi i dokumenteve nga Zyra e IT-is dhe Zyra e Informimit.

**9. Freskimin e faqes zyrtare të Komunës.**

**9.1** Mirëmbajtja e web faqes zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Udhëzimi Administrativ (MAP) Nr.01/2015 për UEB Faqet e Institucioneve.

**9.2** Përgjegjësia për mirëmbajtjen e web faqes së Komunës është e Zyra e IT-is dhe Zyra Informim.

**10. Qasjen e shërbimeve për qytetarë në mënyrë transparente dhe të shpejtë.**

**10.1** Lëshimi e certifikatave dhe ekstrakteve të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, dëshmi që personi është gjallë, dëshmi për vdekje, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve dhe dokumente tjera.

**10.2** Të gjithë formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve sipas pikës 10.1 duhet të publikohen në web-faqen zyrtare ku qytetari të ketë qasje dhe informata për realizimin e të drejtës së tij.

**10.3** Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese. Ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse zyra e IT-së.

**11. Prokurimin transparent. Në këtë kuadër parashikohen:**

**11.1** Njoftimi për kontratë,

**11.2** Njoftim për dhënien e kontratës,

**11.3**, Njoftim për shpallje të tenderëve,

11.4, Njoftim për anulim,

11.5 Njoftim për informata shtesë,

11.6 Njoftim për nënshkrimin e kontratës

11.7 Kontratat e nënshkruara

11.8 Përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve është Zyra e Prokurimit, qe po ashtu dërgon për publikim ne E-prokurim, përkatësisht në KRPP dhe në web faqe të Komunës tek vegëza i Prokurimit: https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/prokurimi/.

11.9 Secili qytetarë e ka mundësinë të hyjë në ueb faqen e KRPP-së (E-prokurimi), njoftimet-prokurimet (kërkim i avancuar) dhe ne bazë kësaj zgjidhet autoriteti dhe njoftimi për çka është i interesuar. Po ashtu edhe në web faqen zyrtare të Komunës tek vegëza: https://kk.rks-gov.net/rahovec/category/prokurimi/, mund të informohet për të gjitha procedurat.

12. **Procedurat e punësimit transparent për qytetarë.**

12.1 Shpallja e konkurseve,

12.2 Njoftimi për përzgjedhjen e kandidatëve,

12.3 Njoftimi për anulimin e konkursit,

12.4 Rishpallja, apo vazhdimi i konkursit,

12.5 Avancimet brenda institucionit,

12.6 Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit te shërbimit civil është Zyra e Personelit, ndërsa për publikimin e tyre Zyra e Informimit dhe Zyra e IT-is.

12.7 Publikimi i të gjitha procedurave në shërbimin civil publikohen në web-faqe zyrtare të komunës, në objektin e Komunës, në media të shkruara dhe atyre elektronike. Publikimi duhet të jetë edhe te institucionet përgjegjëse për shërbimin civil.

13. **Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe besimit të publikut për hartimin e akteve në Komunë. Për të përmbushur këtë objektiv e planit komunal të veprimit për transparencë parashikon ndër të tjera:**

13.1 Ngritjen e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara etj., të cilët në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë do të kenë në qendër të vëmendjes problematikat e këtyre grupeve.

13.2 Organizimin e takimeve me shoqërinë civile për rritjen e bashkëpunimit për të evidentuar rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit.

13.3 Përmirësime sipas nevojës në Rregulloren e Kuvendit për afatet e konsultimit të projekt-akteve me organizatat e shoqërisë civile dhe caktimin e rregullave shtesë për bashkëpunimin dhe qasjen e organizatave të shoqërisë civile në punimet e Kuvendit të Komunës.

13.4 Ndihma tjetër për organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët socialë.

13.5 Publikimi i projekt-akteve në faqen e internetit, si dhe të relacioneve dhe propozimeve përkatëse.

**14. Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Komunës.**

**14.1** Zbatimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera që mundësojnë kontrollin e Kuvendit ndaj Ekzekutivit lidhur me zbatimin e politikave dhe buxhetin vjetor komunal.

**14.2** Caktimi i pikave të veçanta në seanca të KK-së për pyetje drejtuar ekzekutivit për çështje të caktuara me interes publik.

**14.3.** Përfshirja e raporteve të ndryshme të institucioneve dhe organizatave që lidhen me planin e veprimit të punës së Kuvendit.

**15. Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit dhe Komunës si tërësi.**

**15.1** Parashikimin e një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës.

**15.2.** Rritjen e kapaciteteve për shërbimin e teknologjisë së informacionit.

**15.3** Sigurimin e buxhetit nga donacionet për kompensimin e një numri të caktuar të stafit këshillëdhënës për Kryetarin e Komunës, Kryesuesin e KK-së etj.

**16. Numri pa pagesë për t'i dhënë qytetarëve informata lidhur me shërbimet që i ofron Komuna si dhe për të paraqitur kërkesë apo ankesë dhe e-maili zyrtar i Komunës.**

**16.1** Përmes numrit pa pagesë qytetarët do të kenë mundësinë të paraqesin kërkesat apo ankesat e tyre lidhur me qeverisjen lokale dhe për qëllime të marrjes së informatave për shërbimet që ofron Komuna.

**16.2** Numri është nën mbikëqyrjen e Drejtorisë së Administratës.

**16.3** Po ashtu qytetarët do të kenë në shërbim edhe e-mailin zyrtar të Komunës (Komuna.Rahovec@rks-gov.net) ku qytetarët mund të shkruaj dhe të adresojnë pyetje secilit punonjës brenda Komunës.

**17. Plani komunal i transparencës është për katër (4) vite, sipas Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.04/2018, por i njëjti mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas nevojës.**

Kryetari i Komunës

______________

Smajl Latifi

## Objektivat e Planit Komunal të Veprimit për Transparencë 2019-2023

| | Objektivat e planit të veprimit të transparencës | Aktivitet e planit të transparencës | Njësia / apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të Komunës | Vendi i mbajtjes të aktiviteteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunale |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Mbledhjet e rregullta të kuvendit Komunale dhe të Komiteteve të tjera** | Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit Komunal dhe komiteteve bëhet në: Ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në rrjete sociale | Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrës për Informim, njofton qytetarët së paku 7 ditë përpara mbajtjes së mbledhjes | Salla e Kuvendit Komunal. | Njoftimi për mbledhjet e rregullta te Kuvendit Komunal është 7 ditë para mbajtjes. |
| 2 | **Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal** | Njoftimi për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal bëhet në: Ueb faqe zyrtare, ne media të shkruar dhe elektronike, hapësira administrative të Komunës, në rrjete sociale | Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrës për Informim bënë njoftimin për mbledhje. | Salla e Kuvendit Komunal. | Njoftimi për mbledhjet e jashtëzakonshme te Kuvendit Komunal është 3 ditë para mbledhjes.<br><br>**Procedurat e parapara për mbledhjet e jashtëzakonshme nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente.** |
| 3 | **Konsultimet me publikun** | Komuna organizon Konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve: Konsultimet për buxhet dhe dëgjime për planifikim buxhetor, konsultimet për zhvillimin ekonomik lokal, konsultimet për investimet dhe konsultimet për çështje të tjera në interes të përgjithësi. | Sekretaria e Kuvendit përmes njësisë/zyrës për Informim, njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit publik. Njoftimi bëhet: Në ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës dhe në rrejte sociale. | Në sallë e Kuvendit Komunal, ose në objekte me hapësirat të mjaftueshme brenda territorit të komunës për pjesëmarrje të gjerë dhe aktive të publikut. | Njoftim për konsulta me publikun, publikohen **dy javë** para seancës së konsultimeve. |
| 4 | **Takimet me publikun** | Komuna mban së paku **dy** takime publike me qytetarë për çështje të interesit të përgjithshëm, në të cilën mund të marr pjesë secili person apo organizatë me interes në Komunë. | Njoftimi për mbajtjen e takimeve bëhet nga Shefi i kabinetit të kryetarit përmes Zyrës për Informim e cila njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimit | Në sallën e Kuvendit të Komunës, ose në ndonjë vend brenda territorit të Komunës me pjesëmarrje | Njoftim për takimet me publikun , publikohen **dy javë** para mbledhjes së konsultimeve. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Përveç dy takimeve publike, Komuna dhe Kuvendi mund të shqyrtoi mundësin për të mbajtur takime shtesë, dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal, përdorimin e pronës komunale, planifikimin hapësinor, investimet, të hyrat komunale si dhe çështje të tjera në interes të përgjithshëm. | publik. Njoftimi bëhet: Në ueb faqe zyrtare, në media të shkruar dhe elektronike, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës dhe në rrejte sociale | të gjerë dhe aktive të **publikut**. | |
| 5 | **Takime e Kryetarit të Komunës me qytetarë, OJQ-të dhe gazetar** | Kryetari i Komunës në kuadër të kompetencave të tij duhet të realizojë takime me qytetarët. Takimet në formë debati me qytetarët , takime me pyetje dhe përgjigje. Kryetari i Komunës cakton një ditë brenda javës që në Sallën e Kuvendit të këtë takime me qytetarët. | Shefi i kabinetit të kryetarit përmes Zyrës së Informimit bënë njoftimin para mbajtjes së takimit dhe e publikon në web faqe, në rrjete sociale, në media të shkruara dhe elektronike. | Në sallën e Kuvendit Komunal, në sallën e mbledhjeve ose në objekte me hapësira të mjaftueshme. | Njoftimi duhet të bëhen me kohë, në raste të veçanta edhe brenda ditës. |
| 6 | **E drejta e qasjes në dokumente publike** | Kërkesat për qasje në dokumente trajtohen nga cilido institucion publik që posedon dokumentin e mbikëqyrë informatën. Institucioni publik (Komuna) ndihmon kërkuesin, aq sa është e mundshme në bazë të arsyeshmërisë, të identifikojë dokumentin e kërkuar. Kërkesat për qasje në dokumente publike trajtohen në mënyrë të barabartë. | Zyrtari për shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike komunikim bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje ne dokumentet publike dhe i adreson tek njësia ku është dokumenti dhe brenda afatit ligjor prej 7 ditësh i kthen përgjigje palës kërkuese, pas marrjes së dokumentit/informatës nga njësia prodhuese e dokumentit/informatës në pajtueshmëri me Ligjin Nr.03/L2015 për Qasje në Dokumente Publike e dërgon të kërkuesi. | Kërkesat për qasje në dokumente publike mund të parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim ose në formë elektronike. | Organet e Komunës (njësia që posedon dokumentin ) obligohet që brenda shtatë **(7)** ditësh nga dita e pranimit të kërkesës të kthej përgjigje njësisë kërkuese, ndërsa për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesshëm njofton kërkuesin me shkrim dhe informon kërkuesin për të drejtën e tij të ankesës. Afati për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente mund të vazhdohet deri në pesëmbëdhjetë **(15)** ditë, sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike. |
| 7 | **Kërkesë për informim,** | Subjekti fizik ose juridik ka të drejtë të parashtroi | Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, | Kërkesë për informim, | Kërkesat, iniciativat |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **iniciativat qytetare dhe peticionet** | kërkesë për realizimin e ndonjë të drejte, iniciative qytetare dhe peticion, për çështje që janë përgjegjës organet e Komunës.<br>Investimet në interes të përgjithshëm, ku participimi është bashkë me qytetarët.<br>Mbështetje OJQ-ve për realizimin e aktiviteteve në interes të përgjithshëm. | Kryetari i Komunës ose Zyra për Informim, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e shqyrtimit njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit. | iniciativat qytetare dhe peticioni parashtrohen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes kërkesës me shkrim. | qytetare dhe peticionet shqyrtohen nga Kuvendi i Komunës brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh siç është e përcaktuar në nenin 70 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale |
| 8 | **Publikimi i akteve komunale** | Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit të Komunës, publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun pas vlerësimit te ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal | Zyra e Kuvendit ,Zyra e Informimit dhe Zyra e IT-is dhe njësit që posedojnë dokumentacionet për publikim. | Të gjitha aktet nënligjore dhe dokumenteve tjera publike duhet të publikohet në ueb faqe të Komunës, media të shkruara dhe elektronike, apo në rrjete sociale. | Aktet nënligjore të komunave publikohet në faqe zyrtare 15 ditë pas regjistrimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, ndërsa dokumentet tjera publike publikohen pas hyrjes në fuqi. |
| 9 | **Freskimi i web faqes zyrtare të Komunës** | Web-faqja zyrtare e Komunës bëhet sipas Udhëzimit Administrativ (MAP) Nr.01/2015 për UEB Faqet e Institucioneve. | Obligohen Zyra e IT-is dhe Zyra e Informimit që të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Udhëzimi Administrativ. | Web faqja e institucionit publik gjithashtu duhet të ketë: Hartën e faqes, lidhja (Vegëza) me portalin shtetëror dhe ueb faqet e institucionev e vartëse dhe lidhjen (Vegëzën) me Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe linçeve të tjera që janë ne interes të përgjithshëm. | Mirëmbajtja ueb-faqen zyrtare duhet të jetë funksionale ashtu siç e përcakton Administrativ (MAP) Nr.01/2015 për UEB Faqet e Institucioneve. |
| 10 | **Qasja e Shërbimeve për qytetarët në mënyrë transparente dhe të shpejtë** | Certifikata të lindjes, certifikata të vdekjes, certifikata të martesës, certifikata të statusit martesor, dëshmi për personin që është gjallë, dëshmi për vdekjen, e cila u shërben qytetarëve | Zyra e Gjendjes Civile është njësi prodhuese e tyre dhe furnizuese për palën kërkuese. Ndërsa për publikimin e formularëve është përgjegjëse zyra e IT-së dhe Zyra e | Formularët për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve duhet publikuar në web faqen zyrtare, ku | Në web faqe zyrtare te Vegëza e shërbimeve për qytetarët, publikohen edhe procedura për shërbime dhe afate e caktuar |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | për trashëgimi, vërtetimin që është mbajtës i familjes, regjistrimi i lindjeve, regjistrimi i vdekjeve, regjistrimi i kurorëzimeve nga bota e jashtme për të gjitha komunat e Kosovës, si dhe certifikatat mbi bashkësitë familjare. | Informimit. | qytetari ta ketë qasjen e lehtë. | për kryerjen e shërbimeve. |
| 11 | **Prokurimi Transparent** | Njoftim për dhënien e kontratës, Njoftim për anulim Njoftimi për vazhdimin e afatit Njoftim për nënshkrimin e kontratës, kontratat e nënshkruara dhe dokumentet të tjera të prokurimit. | Përgjegjëse për përgatitjen e dokumenteve është Zyra e Prokurimit, e cila i dërgon këto njoftime për publikim ne E-prokurim, përkatësisht në KRPP, në Zyrën e IT-is dhe në Zyrën e Informimit. | Njoftimet nga fusha e prokurimit bëhen në web e KRPP-së dhe në web faqen e Komunës së Rahovecit, tek Vegëza e Prokurimit. | Të gjitha njoftimet e prokurimit bëhen publike sipas afateve ligjore në fushat e prokurimit. |
| 12 | **Procedurat e punësimit transparente për qytetarët** | Shpallja e konkurseve, njoftimi për përzgjedhjen e kandidateve, njoftimi për anulimin e konkursit, rishpallja, apo vazhdimi i konkursit, avancimet brenda institucionit. | Përgjegjës për kompletimin e procedurave të rekrutimit të shërbimit civil është Zyra e Personelit, ndërsa për publikimin e tyre është Zyra e IT-is dhe Zyra e Informimit. | Publikimi i procedurave në shërbimin civili publikohen ne web faqe zyrtare të Komunës, rrjetet sociale dhe në tabelën para objektit të Komunës. | Publikimi dhe zbatimi i procedurave të shërbimit civil bëhet në përputhje me legjislacioni e shërbimit civili. Afatet për shpalljen e konkursit, njoftimit të kandidateve, vazhdimi i konkurseve etj. |
| 13 | **Rritja e bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe besimit të publikut për hartimin e akteve në Komunë** | Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e të drejtave të kategorive të veçanta si; fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufizuara etj. Organizimin e takimeve me shoqërinë civile për rritjen e bashkëpunimit për të evidentuar rrugët dhe mënyrat e bashkëpunimit. Përmirësimi sipas nevojës në Rregulloren e Kuvendit për afatet e konsultimit të projekt-akteve me organizatat e shoqërisë civile dhe caktimin e rregullave shtesë. | Komuna harton propozime për Kuvend, ndërsa kjo e fundit miraton aktet që kanë të bëjnë në përmirësimin e bashkëpunimit me shoqërinë civile, kurse Zyra e IT-së dhe Zyra e Informimit publikon aktet dhe dokumentet që nxirren nga Komuna dhe Kuvendi. | Publikimi i projekt-akteve bëhet në web faqen zyrtare të Komunës. | Publikimi i akteve të miratuara nga Komuna dhe Kuvendi publikohen pas shqyrtimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja (vetëm ato që duhet të shqyrtohen për ligjshmëri nga MAPL-ja). |
| 14 | **Forcimi i rolit mbikëqyrës të** | Zbatimi i dispozitave ligjore dhe akteve tjera | Komuna (ekzekutivi ) propozon Kuvendit | Propozimet mund të dalin | Pas caktimit të sugjerimeve, ato |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **Kuvendit të Komunës** | që mundësojnë kontrollin e Kuvendit ndaj Ekzekutivit lidhur me zbatimin e politikave dhe buxhetit vjetor komunal. | pika të caktuara që janë në interes të përgjithshëm. | nga mbledhja e Këshillit të drejtorëve, dhe ju dërgohen Sekretarisë së Kuvendit, pastaj drejtohen të KPF-ja. | dërgohen në Komitetin për Politikë e Financa të cilat caktohen 7 ditë para mbledhjes. |
| 15 | **Forcimi i kapaciteteve administrative** | Parashikimin e një buxheti të veçantë për trajnimin e administratës. Rritja e kapaciteteve për shërbimin e Teknologjisë Informative dhe sigurimin e buxhetit nga donacione për kompensimin e një numri të caktuar të stafit këshilledhënës për Kryetarin e Komunës dhe Kryesuesin e Kuvendit. | Administrata komunale dhe Kuvendi i Komunës mund të planifikojnë politika për realizimin e kësaj objektive. | Dokumentet që miratohen nga ekzekutivi dhe legjislativi publikohen në web faqe të Komunës. | Njoftimi behët me kohë sipas dispozitave ligjore në fuqi |
| 16 | **Numri i telefonit pa pagesë për t'i dhënë informta qytetarëve lidhur me shërbimet që i ofron Komuna si dhe për të paraqitur kërkesë apo ankesë dhe e-maili zyrtar i Komunës** | Numri i telefonit pa pagesë ka për qëllim bashkëpunimin mes qytetarëve të cilëve u jepet e drejta për të paraqitur kërkesë apo ankesë dhe për t'u informuar me shërbimet e Komunës, si dhe e-maili zyrtar (Komuna.Rahovec@rks-gov.net) ku qytetarët mund të shkruajnë dhe të adresojnë pyetje për punëtorët e administratës komunale. | Drejtoria e Administratës Komunale dhe Zyra e IT-së | Numri i telefonit duhet të vendoset në objektin e Komunës dhe në web faqen zyrtare. E-maili zyrtar është i publikuar në web faqe të Komunës | Secila kërkesë, apo ankesë e thirrjeve dhe e dërgimit përmes e-mail, do të këtë afatin ligjor në dispozicion për shqyrtimin e saj. |

Në bazë të nenit 12, nenit 17, dhe nenit 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15, qershor 2008), nenit 10, nenit 40 paragrafi 2.2 dhe nenit 57, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.04.2019 merr këtë:
:

VENDIM

**Për ndarjen e mjeteve financiare për festivalin tradicional mbarëkombëtare të folklorit "Anadrinia Jehon 2019"**

1. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës Nr.01/143/19 i datës19.04.2019, dhe merret vendim për mbështetje financiare të Festivalit Tradicional Kombëtar të Folklorit "Anadrinia Jehon 2019" edicioni 18 dhe i ndahen mjetet financiare në shumë prej 5500.00€ ( Pesëmijë e pesëqind euro.

2. Shuma e cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të shërbej për organizimin e festivalit "Anadrinia Jehon 201".

3. Mjetet të sigurohen nga kodi i mallra dhe shërbime.

4. **AUTORIZOHET** Kryetari i Komunës që, konform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për lejimin e mjeteve për organizimin e festivalit.

5. Obligohet organizatori i festivalit "Anadrinia Jehon 2016" që të sjell raportin me shkrim për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve.

6. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS NËRAHOVEC**

**01-Nr-_______**
**Me datë_________**

**Afrim Dina**

________________
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*
**Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor**

Nr. protokollit 01 \ 1143\19
Me datë: 19.011.2019
Rahovec

Në bazë të nenit 13, 17 dhe 58, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/15, qershor 2008) nenit 7 paragrafi 5 nenit 57, 63, 74, dhe 92 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Kuvendit të Komunës në Rahovec i:

**PROPOZON**
**Marrjen e vendimit për mbështetje financiare për Festivalin Tradicional Kombëtar të Folklorit "Anadrinia Jehon 2018"**

1. Kryetari i Komunës i propozon Komitetit për Politikë e Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, marrjen e vendimit për mbështetje financiare të edicionit të 18, Festivali Tradicional Kombëtar i Folklorit "Anadrinia Jehon 2019" dhe të ndahen mjetet financiare në shumë prej 5500.00€ (Pesëmijë e pesëqind euro)

2. Shuma e cekur në nenin **1** të këtij propozimi do të shërbej për organizimin e festivalit "Anadrinia Jehon 2019".

3. Mjetet të sigurohen nga kodi mallra dhe shërbime.

4. Të obligohet këshilli organizues i festivalit "Anadrinia Jehon 2019" që të sjell raportin me shkrim për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve.

5. Shtojcë e këtij propozimi është edhe specifikacioni i shpenzimeve të festivalit "Anadrinia Jehon 2019"

***U dërgohet:***
1. ***Kuvendit të Komunës***
2. ***Sekretarisë së Kuvendit dhe***
3. ***Arkivit.***

***Smajl LATIFI***
***Kryetari i Komunës***

# Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), nenit 51 dhe 52, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të nenit 4, 5, 6 dhe 7 të udhëzimit Administrativ-MAPL-së, Nr. 03/2014, Udhëzimit Administrative NR.02/2018 për ndryshimin Nr.03.2014 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komuna, neneve 2, 10 paragrafi 1 dhe 2.4, neni 30, 32, dhe 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në Mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2019 merr këtë:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 591 të datës 16.02.2018, për Themelimin e Komitetit për Komunitete**

**1.** Me këtë vendimi ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01Nr.591 i datës 16.02.2018 për Themelimin e Komitetit për Komunitete, me qëllim të zëvendësimit të anëtarit/es të Komitetit për Komunitete për shkak se ky vend është vakant pas dorëheqjes së kuvendares Bjondina Kleqka.

**2.** Pika 2.2 e vendimit bazik ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

**2.1 Shqipe Tara**, anëtare e Kuvendit të Komunës së Rahovecit nga radhët e partisë politike, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK, emërohet anëtare e Komitetit për Komunitete.

**3.** Pikat tjera të vendimit bazik me numër 01Nr.591 i datës 16.02.2018, mbesin të pa ndryshuara.

**4.** Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit.

***U dërgohet:***

- ***Kuvendit,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***MAPL-së***
- ***Arkivi***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr-_______**
**Me datë__________**

**Afrim Dina**

____________________

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (e), nenit 51 paragrafi 51.2 dhe nenit 73, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2016 të datës 21.10.2016, për Procedurën e Themelimit, Organizimit dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, neneve 2, 10 paragrafi 1 dhe 2.4, neni 34, 35, 36 dhe 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2019 merr këtë:

## VENDIM

### Për Themelimin e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, shpalljen e konkursit dhe caktimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve në komitet

1. **Miratohet** vendimi për Themelimin e Komitetit Konsultativ në Komunën e Rahovecit për persona me aftësi të kufizuara, shpalljen e konkursit dhe caktimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të komitetit.

2. Komiteti konsultativ për persona me aftësi të kufizuara i cekur në pikën 1 (një), të këtij vendimi përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga qytetarë dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare të cilët janë njohës të fushave përkatëse.

3. Caktimi i anëtarëve në Komitetin për persona me aftësi të kufizuara të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, bëhet përmes shpalljes së konkursit publik, me mandat 3 vjeçar, me mundësi përzgjedhje edhe për një mandat.

4. Kuvendi i Komunës shpall konkurs dhe përcakton kriteret për konkurrim.

**4.2** Kuvendi i Komunës në Rahovec, për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara, formon panelin përzgjedhës, i caktuar dhe i miratuar nga Kuvendi i Komunës në Rahovec në këtë përbërje:

**4.2.1** ________________ anëtare e Kuvendit
**4.2.2** ________________ anëtar i Kuvendit
**4.2.3** ________________anëtare e Kuvendit
**4.2.4** ________________anëtare e ekzekutivit
**4.2.5** ________________anëtar i shoqërisë civile

5. Kompetencat e Komitetit Konsultativ për persona me aftësi të kufizuara: dhënia e propozimeve të rregulloreve të ndryshme, hulumtime të ndryshme, mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga Kryetari i Komunës, komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushën përkatëse, paraqitja e pikëpamjeve dhe mendimeve të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës, propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara, propozime këto të cilat nuk janë obliguese për Kuvendin e Komunës, por duhet të merren parasysh në zhvillimin e politikave komunale.

6. Çështje tjera lidhur me Komitetin konsultativ janë rregulluara me Udhëzimit administrativ, Nr-01/2016, për procedurën e themelimit, organizimit dhe kompetencave të komiteteve konsultative në Komuna.

7. Për punën që do ta kryejnë anëtarë e komitetit konsultativ do të kompensohen nga 50€, për çdo mbledhje që do ta mbajnë, pagesa bëhet nga mjetet vetanake të Komunës së Rahovecit.

8. Anëtaret e komitetit konsultativ nuk mund të kompensohen për me shumë se gjashtë (6) mbledhje të cilat mbahen brenda vitit.

9. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.

10. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***U dërgohet:***

- ***MAPL-së***
- ***Arkivi***

**KUVENDI I KOMUNËS NËRAHOVEC**

**01-Nr-_______**
**Me datë__________**

**Afrim Dina**

__________________

**Kryesues i Kuvendit**

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (h), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neneve 2, 10 dhe nenit 40 paragrafi 2.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.04.2019 merr këtë:

**D R A F T - V E N D I M**
**Për Themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike "Sulejman Krasniqi"**

1. **Miratohet propozimi** i Kryetarit të Komunës Nr. 01/126/19 i datës 05.04.2019 dhe merret vendimi për Themelimin e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi".

2. Ky çmim themelohet dhe ndahet, për të gjithë ata që kontribuuan për kulturën, historinë, ruajtjen e kultivimin e vlerave të traditës në periudha të ndryshme historike,

3. Vlera e çmimit për krijimtari letrare e artistike "Sulejman Krasniqi", do të jetë 500.00€ (pesëqind euro) dhe e ndanë Kryetari i Komunës për çdo vit në ditën e bibliotekës së Rahovecit me datë 7 dhjetor.

4. Autorizohet Kryetari i Komunës që për çdo vit me vendim të veçantë të caktojë, komisionin që do të shqyrtojë dhe propozojë dhënien e Çmimit, duke u bazuar në kriteret, e veçanta profesionale dhe kontribute të shquara në fushat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Çmimi "Sulejman Krasniqi" mund t'ju jepet edhe familjarëve të personave të cilët i kanë kontribuuar krijimtarisë letrare, artit dhe kulturës edhe pas vdekjes.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

7. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, MAPL-së dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.

***U dërgohet:***
- ***DKRS-së***
- ***MAPL-së***
- ***Arkivi***

**K U V E N D I I K O M U N Ë S N Ë R A H O V E C**

**01-Nr-_______**
**Me datë_________**

**Afrim Dina**
________________
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

***Komuna Rahovec***

*OpštinaOrahovac/Municipality Rahovec*

**Kryetari i Komunës – Predsednik Opstine – Municipal Mayor**


Nr. protokolli 01/126/19
Me dt. 05.04.2019
Rahovec

Në bazë nenit 58 shkronja (h), 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (h), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neneve 2, 10 dhe nenit 40 paragrafi 2.7 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës, Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit:

**PROPOZON**

**Marrjen e vendimit për themelimin e çmimit për krijimtari letrare e artistike "Sulejman Krasniqi"**

1. Kryetari i Komunës së Rahovecit i propozon Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit, miratimin e vendimit për themelimin e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi".

2. Ky çmim themelohet dhe ndahet, për të gjithë ata që kanë kontribuuar për kulturën, historinë, ruajtjen e kultivimin e vlerave të traditës në periudha të ndryshme historike.

3. Vlera e çmimit letrar "Sulejman Krasniqi", do të jetë 500.oo€ ( Pesëqind euro) dhe e ndan Kryetari i Komunës, për çdo vit në Ditën e bibliotekës "Sulejman Krasniqi" më 7 dhjetor.

4. Autorizohet Kryetari i Komunës që për çdo vit me vendim të veçantë të caktojë komisionin që do të shqyrtojë dhe propozojë dhënien e Çmimit, duke u bazuar në kritere të veçanta profesionale dhe kontribute të shquara në fushat e cekura më sipër.

5. Çmimi "Sulejman Krasniqi" mund t'ju jepet edhe familjarëve të personave të cilët i kanë kontribuuar artit dhe kulturës pas vdekjes.

***U dërgohet:***

- ***KPF-së,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Arkivit.***

**Smajl Latifi**

**Kryetari i Komunës**